

revista



E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2003

Në këtë numër:

Reforma institucionale dhe Integrimi Europian

- Roli i asambleve parlamentare dhe diplomacia parlamentare: Rasti i Shqipërisë.
- Acquis communautaire: Një koncept themelor i Integrimit Europian.
- Opinion në lidhje me Statutin e Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare.
- Proceset e globalizimit të së drejtës

E Drejta Kushtetuese

- Disa argumente juridiko - politike për pavarësinë e Kosovës

12

Botim i Qendrës së Studimeve
Parlamentare

PERMBAJTJA E REVISTES:

Numri XII, viti 2003

Faqe

Reforma institucionale dhe integrimi europian

Roli i asambleve parlamentare dhe diplomacia parlamentare: rasti i Shqipërisë
Leon SHESTANI 4

Disa shënime në lidhje me Statutin e Romës për Gjykatën
Penale Ndërkombëtare
Ditmir BUSHATI 21

Acquis communautaire: Një koncept themelor i Integritit Europian
Odeta KUMBARO 39

Proceset e globalizimit të së drejtës
Mireille DELMAS-MARTY 56

E Drejta Kushtetuese

Disa argumente juridiko-politike për pavarësinë e Kosovës
Prof.Dr. Arsim BAJRAMI 71

Nga punimet e Kuvendit

Nga punimet e Kuvendit për periudhën Dhjetor 2002
Alma KONDAKÇI 80

Informacion mbi legjislacionin e miratuar
Filip LAKO 87

Përmbledhje në anglisht

Informacion mbi legjislacionin e miratuar 93

TABLE OF CONTENTS:

12 issue, year 2003

	Page
<hr/>	
Institutional reform and European Integration	
The role of parliamentary assemblies and parliamentary diplomacy: case of Albania	4
Leon SHESTANI	
Some notes related to the Statute of Rome about the International Penal Court	21
Ditmir BUSHATI	
Acquis communautaire: A basic concept of European Integration	39
Odeta KUMBARO	
Law globalization processes	56
Mireille DELMAS-MARTY	
<hr/>	
Constitutional Law	
Some political-juridical arguments related to Kosova Independence	71
Prof.Dr. Arsim BAJRAMI	
<hr/>	
Parliamentary proceedings	
Report on parliamentary proceedings in the period December 2002	80
Alma KONDAKÇI	
Information on laws passed by the Assembly	87
Filip LAKO	
<hr/>	
Summary in English:	
Information on laws passed by the Assembly	93
<hr/>	

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizmin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studjuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanëshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Roli i asambleve parlamentare dhe diplomacia parlamentare: Rasti i Shqipërisë

*Leon Shestani
Anëtar i Bordit QSP*

i. Kërkesë që vjen si rezultat i zhvillimeve globale?

Vitet e fundit janë karakterizuar nga një rritje e problematikës që lidhet me globalizimin. Kjo është shoqëruar me të gjitha të rejtat dhe pyetjet që sjell një dukuri e re, çka është reflektuar edhe në rolin e asambleve parlamentare. Këto, në një mënyrë ose në një tjetër, kanë shqyrtuar ose janë përballuar me pyetjen se si të gjejnë rrugë të modernizohen, në mënyrë që të përmbushin mandatin e tyre që tradicionalisht ka qenë i kuadruar ose i kufizuar brenda logjikës së institucioneve të veçanta.

Është pikërisht në përputhje me këto, që parlamentet synojnë të rrisin rolin e tyre dhe të marrin pjesë aktive edhe në vendimmarrje, që deri tani ka qenë e konsideruar si zonë (preserve) e qeverive.

Po kështu, shoqëria ka kaluar nëpërmjet ndryshimeve radikale. Sot jemi dëshmitarë të një pjesëmarrjeje të gjerë të publikut në jetën e vendit dhe atë politike. Veçanërisht kjo e lidhur ngushtësisht me çështjet e politikës së jashtme. Opinioni publik po ndërgjegjësohet se gjithnjë e më tepër, politika e vendeve fqinje ose partnere ndikon dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në jetën e tyre të përditshme.

Kjo bën që, për rrjedhojë, zgjedhësi pret si një gjë normale e legjitime

faktin që parlamentarët duhet të sigurojnë që aspiratat e tij të përmbushen në zgjedhjet që bën ekzekutivi dhe në plan më të gjerë se politikat thjesht brenda kontureve të kufijve kombëtarë ose shtetërore.

Shumë njerëz mendojnë se, në ndryshim nga qeveritë, institucionet parlamentare janë të paafta të marrin vendime brenda kornizave ekzistuese që tanimë janë të pamjaftueshme. Si rezultat, roli i asambleve, si organe përfaqësuese *vis a vis* të gjetjes së zgjidhjeve të problematikës së përditshme, ka rënë. Pavarësisht nga fakti që duhet të jenë forumet ato ku shprehen ose marrin jetë aspiratat e elektoratit, parlamentarët janë të përjashtuar (lënë pas dore) nga bota reale, sepse e kanë të pamundur të vlerësojnë të gjitha aspektet e problematikës që duhet të shqyrtojnë. Ato janë konsideruar shpeshherë si institucione që i përkasin të kaluarës.

Nevoja për kontakte ndërmjet parlamentarëve u ka dhënë jetë një sërë nismash. Kjo po konsiderohet gjithnjë në një mënyrë më të strukturuar dhe të organizuar, duke sjellë atë bashkëpunim parlamentar që është zëvendësuar tashmë në kuptimin e tij më të plotë nga “diplomacia parlamentare”. Ky term mbulon lidhjet e të gjitha llojeve, institucionale ose tradicionale, si dhe ato që krijohen spontanisht ose rishtazi dhe më tej institucionalizohen, duke u mundësuar parlamentarëve të veprojnë në një terren që i kalon kufijtë kombëtarë ose shtetërorë.

Objekti është iniciimi i nismave të projektuara, që ndikojnë në vendimet politike të ekzekutivit dhe t’i hapin rrugën zgjidhjeve praktike. Diplomacia parlamentare ka avantazhin që kanë parlamentarët në komunikimin më informal, në metodat e paraqitjes së problemeve dhe të veprimtarisë së tyre. Kjo sidomos përsa i përket shkëmbimit të pikëpamjeve të zgjidhjeve ose zgjedhjeve ndaj elektoratit.

Sfida, që përballojnë në ditët e sotme parlamentet si trupa përfaqësues, është që të vazhdojnë të shprehin aspiratat e popullit, duke analizuar problematikën në thellësi dhe duke propozuar zgjidhje strategjike legjislative, ndërsa i duhet të vazhdojnë t’u bëjnë presion qeverive të veprojnë në drejtim të projekteve të veçanta.

ii. Genesis i bashkëpunimit në asamblëtë parlamentare

Tradicionalisht parlamentet i kanë mbajtur marrëdhëniet e tyre në bazë të kortezi së së ndërsjellë. Ato realizoheshin në formën e ftesave, vizitave, misioneve fakt mbledhëse, kryesisht për kryetarët e parlamenteve ose të dërguarit e tyre.

Por parlamentarët, të cilët klasikisht nuk kanë detyra zyrtare, nuk ishin të përfshirë në kontakte jashtë territorit të vendit të tyre deri në vitin 1889, kur dy anëtarë të parlamenteve, William Randal Cremer (Britania e Madhe) dhe Frederic Passy (Francë) organizuan ose mblodhën, si thuhej në atë kohë, të parin kuvend “ndërparlamentar” në Paris. Ky kuvend kishte pjesëmarrës nga nëntë vende të ndryshme dhe i dha jetë krijimit të Bashkimit Ndërparlamentar.

Sot Bashkimi Ndërparlamentar (IPU) ka më shumë se 140 vende anëtare dhe një sekretariat të përhershëm në Gjenevë. Ai organizon dy konferenca vjetore lidhur me tema të interesit të përbashkët dhe të aktualitetit. Synimi i Bashkimit Ndërparlamentar është të promovojë kontaktet, bashkërendimin dhe shkëmbimin e pikëpamjeve, me synim nxitjen dhe vënien në lëvizje të parlamenteve kombëtare. IPU nuk është i ndërruar nga një traktat ndërkombëtar, por nga një kontekst marrëveshjes të bëra nga parlamentet kombëtare, të cilat çuan në mënyrë graduale në krijimin e një strukture koherente.

Gjatë gjithë shekullit XX, IPU u përshtat dhe u mbijetoi ndryshimeve të mëdha institucionale që ndodhën në mbarë botën, duke u transformuar në një forum në të cilin anëtarët reflektojnë kultura të ndryshme politike dhe parlamentare. Ai ka luajtur një rol të rëndësishëm në vendosjen e kontakteve me vendet e botës së tretë, të cilat në mënyrë graduale i kanë ndërtuar kushtetutat e tyre duke marrë shembull asamblëtë e vendeve perëndimore.

Gjatë periudhës së luftës së ftohtë, konferencat e IPU-së u mundësuan përfaqësuesve nga të dyja blloqet të mbajnë kontakte dhe të angazhohen në dialog në nivelin e negociatave zyrtare. Këto përvoja i bënë parlamentarët të vetëdijshëm për nevojën e shkëmbimit të ideve dhe informacionit.

Po kështu, kur organizmat e bashkëpunimit ndërkombëtar po krijoheshin në vitet pesëdhjetë, nevoja për të përfshirë anëtarë nga parlamente të ndryshme, çoi në krijimin e një asambleje të formuar nga delegacione parlamentare, para së gjithash, në Këshillin e Europës dhe më vonë ECSC (European Cooperation on Steel and Coal), organizatë që i parapriu Komunitetit Europian. Kjo Asamble më vonë u transformua në Asamblenë Ndërparlamentare Europiane, që më vonë u bë Parlamenti Europian, anëtarët e të cilit sot zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë.

Në korrik 1955, Asambleja e Bashkimit Europian Perëndimor u krijua bazuar mbi nenin IX të traktatit të modifikuar të Brukselit. Anëtarët e saj ishin pjesë e anëtarësisë së Asamblesë Konsultative të Këshillit të Europës. Menjëherë më pas, megjithëse traktati i Uashingtonit nuk kishte asnjë referencë për ekzistencën e një asambleje, u krijua Asambleja e Atlantikut Verior si një strukturë e ngjashme.

Në vitin 1991, Karta për një Europë të Re, që u nënshkrua në kuadrin e Konferencës së Parisit, çoi në krijimin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së. Dy vjet më vonë, në vitin 1993, u krijua Konferenca Parlamentare e Nismës së Europës Qendrore. Asamble të tjera parlamentare europiane janë: Asambleja Baltike dhe Asambleja që mbledh vendet anëtare të BENELUX-it.

Së fundi, në vijim të ndryshimeve që ndodhën në Europën Lindore, u krijuan dhe dy asamble tjera: Asambleja Parlamentare e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (PABSEC), dhe Asambleja Ndërparlamentare e Komunuellthit të Shteteve Indipendente.

Të gjitha asambletë e ndryshme, që janë kopjuar në botë në trupa të ngjashëm rajonalë, janë forume për këshillime shumëpalëshe dhe tashmë janë të mirëstrukturuara dhe të organizuara. Çdo parlament anëtar emëron një delegacion, i cili merr pjesë në mënyrë të rregullt në sesionet plenare dhe në takimet e komisioneve të specializuara.

Mënyra e funksionimit është e ngjashme me atë të parlamenteve kombëtare. Këto institucione kanë një rol kyç në ndërgjegjësimin e parlamentarëve dhe për informimin e tyre lidhur me çështje që kanë të bëjnë me objektivat e organizatave të ndryshme, pjesë e të cilave janë vetë ata. Gjithashtu, ata janë një mjet për arritjen e konsensusit dhe të ushtrimit të presionit mbi procedurat legjislative dhe zgjedhjet e bëra nga qeveri të ndryshme.

Në asamblëtë ndërkombëtare marrin jetë pikëpamjet e parlamentarëve që vijnë nga vende me tradita dhe kultura të ndryshme parlamentare. Vendimet që ata marrin janë një tregues për zgjedhjet ose zgjidhjet politike dhe reflektojnë interesat e të gjithë palëve. Janë këto arsytet që e bëjnë të domosdoshëm faktin që këto asamble e kanë të domosdoshme të kalojnë nga bashkëpunimi parlamentar drejt diplomacisë parlamentare. Kjo çon gradualisht drejt krijimit të një ndërgjegjeje kolektive rreth interesave të përbashkët, gjë që lehtëson punën përgatitore në menaxhimin e negociatave formale ndërmjet qeverive.

iii. Nga bashkëpunimi parlamentar te diplomacia parlamentare: protagonistët në parlamentet kombëtare

Në epokën e rritjes drastike të aftësive dhe mjeteve të komunikimit, si dhe të globalizimit të problematikës që trajtojnë, asamblëtë ndërkombëtare filluan menjëherë të marrin nisma të reja që mbulonin çështje dhe zona, për të cilat ende nuk kishte forume me kompetencë relevante, si dhe të vlerësonin mundësitë e diskutimit të këtyre ideve.

Në një farë mënyrë, institucionet i ngrinë kontaktet në të gjitha nivelet dhe filluan të përcaktojnë forma të reja lidhjesh të strukturuar dhe të rregullta. Situata mund të krahasohet me një piramidë të veprimtarive ndërkombëtare që fillonte me kryetarët e asambleve në krye të tyre, vijonte me komisionet e specializuara, si dhe me grupet parlamentare të vendosura në qendër të marrëdhënieve formale dhe të shërbimeve parlamentare, në bazën e saj.

Fillimisht, ishin kryetarët e asambleve që ndihmuan në krijimin e një rrjeti kontaktesh ndërmjet institucioneve në baza dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Në sajë të personalitetit të tyre, falë faktit që të gjithë ishin politikanë të standardit ndërkombëtar, roli i tyre përfaqësues ka pësuar ndryshime në kohët e tanishme, duke i dhënë me shumë rëndësi misioneve dhe vizitave të kryetarëve të shteteve dhe të qeverive.

Me institucionalizimin e konferencës së kryetarëve të parlamenteve, vizitat e kortezisë dhe takimet ndërmjet kryetarëve të parlamenteve filluan të organizohen në intervale të rregullta. Këto konferenca në vendet anëtarë të BE-së mbahen tashmë çdo vit për çështje të interesit të përbashkët dhe veçanërisht për çështje që i përkasin marrëdhënieve me vende që i përkasin vendeve të afërta gjeografikisht në zonën e Bashkimit European, Europës Lindore dhe të Mesdheut.

Me nismën e Presidentit të Parlamentit European, Gaetano Martino, u mbajt konferenca e parë në vitin 1963. Por konferencat filluan të zhvillohen në baza më të rregullta duke filluar nga viti 1975. Sistemi u ndryshua në vitin 1980, ku një konferencë e kufizuar e tri vendeve të treshes së Bashkimit European, plus Parlamentin European, alternohet çdo vit me një konferencë më të gjerë që përfshin të gjithë anëtarët, si dhe kryetarët e Asamblesë të Këshillit të Europës dhe asaj të Bashkimit European Perëndimor.

Një zhvillim kuptimplotë ka shënuar mbajtja e konferencës për zhvillimin e marrëdhënieve me vendet që i përkasin Nismës së Europës Qendrore (Trieste 1977, Graz 1998), si dhe për Partneritetin Euro-Mesdhetar (Palermo 1996 dhe 1998, Athinë 1997, Palma de Majorjka 1999). Një zhvillim i mëtejshëm ishte krijimi i një forumi parlamentar mesdhetar të qëndrueshëm, i cili përbën përmasën parlamentare të Konferencës së Barcelonës.

Kontakte me të ngushta ndërmjet kryetarëve të parlamenteve të Bashkimit European u vendosën në Helsinki në vitin 1997. Këto i dhanë jetë krijimit të një grupi pune ndërparlamentar, për harmonizimin e rregullimeve legjislative dhe thjeshtësimin e legjislacionit kombëtar dhe komunitar.

Shembulli i parë i marrëdhënieve të institucionalizuara ndërmjet trupave parlamentare mund të evidentohet në Konferencën e Komisioneve të

Çështjeve Europiane të Parlamenteve të Bashkimit Europian (COSAC), e cila u krijua në vitin 1989, frymëzuar nga një propozim që erdhi nga Presidenti i Asamblesë Kombëtare të Francës, bërë në Konferencën e Kryetarëve të Parlamenteve në Madrid.

Për të vënë në dukje faktin se sa e rëndësishme është për parlamentet që të punojnë për çështje të interesit të përbashkët, për krijimin e lidhjeve të qëndrueshme me homologët në asamblëtë e tjera, mund të nënvizohet fakti se protokollin që i është bashkëngjitur Traktatit të Amsterdimit ka një dispozitë të veçantë mbi rolin e parlamenteve kombëtare në Bashkimin Europian, që rregullon dialogun ndërmjet COSAC-ut dhe institucioneve europiane, si dhe mbi shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit. COSAC-u mblidhet dy herë në vit në parlamentin e vendit që ka presidencën e radhës së Bashkimit Europian.

Komisionet e politikës së jashtme të parlamenteve kombëtare kanë qenë tradicionalisht shumë aktive në vendosjen e kontakteve të dyanshme me homologët në vende të ndryshme. Në të gjitha parlamentet kombëtare, këto komisione kanë qenë në mënyrë të vazhdueshme komisionet që u është besuar ose deleguar detyra e përfaqësimit, që shpesh dhe në përgjithësi është përkthyer ose kufizuar me vizita protokollare të ndërsjella.

Rritja e numrit të kontakteve dhe shkëmbimeve çoi në vitin 1995 në krijimin e Konferencës së Kryetarëve të Komisioneve të Jashtme të Parlamenteve Kombëtare të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, si dhe të Parlamentit Europian. Kjo Konferencë mblidhet dy herë në vit në parlamentin e vendit që ka presidencën e radhës së Bashkimit Europian, ashtu sikurse dhe COSAC-u.

Në vitet e fundit kjo Konferencë ka mirëpritur vëzhgues që vijnë nga vendet që synojnë dhe kanë aplikuar për anëtarësi në institucionet europiane. Kanë qenë veçanërisht interesante takimet që i paraprinë përgatitjeve përfundimtare për ratifikimin e traktatit të Amsterdimit. Gjatë këtyre takimeve u diskutua *inter alia* lidhur me krijimin e Gjykatës së Krimeve

Ndërkombëtare, marrëdhëniet me vendet e Europës Lindore, si dhe për ndryshimet e reformimit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Një avantazh nga këto takime kanë pasur edhe grupet politike, sidomos në Këshillin e Europës dhe në Asamblenë e Bashkimit të Vendeve Perëndimore. Këto i kanë dhënë mundësi që të organizojnë veprimtaritë e tyre, në mënyrë të ngjashme me ato që janë organizuar në parlamentet kombëtare. Kështu, në këto struktura janë krijuar grupe politike ndërkombëtare, të cilat mbliidhen në kuadër të sesioneve, për të rënë dakord ose për të diskutuar qëndrimet për përcaktimin e vijës politike. Po ashtu, ata vendosin mbi emërimin e përfaqësuesve (kandidatëve) të tyre për forumet e asambleve parlamentare ku ata bëjnë pjesë.

Mbështetja administrative dhe shërbimet e dokumentacionit në këto asamble i janë përgjigjur ndryshimeve dhe zhvillimeve, si dhe rritjes së nevojës për marrëdhënie më jashtë. Këto shërbime tashmë përbëjnë një rrjet të gjerë dhe aktiv që i ushqen këto marrëdhënie dhe, duke përdorur teknologjitë e reja moderne, ia transmeton këtë pasuri informacioni parlamenteve kombëtare në mënyrë konstante dhe të vazhdueshme, si dhe gjatë të gjitha legjislativave.

Në të njëjtën kohë ato janë një burim informacioni dhe për publikun e gjerë. Këtu vlen të përmendet se Shoqata e Sekretarëve të Përgjithshëm të Asambleve Legjislative ekziston në kuadër të Bashkimit Ndërparlamentar dhe Qendrës Europiane për Kërkime Parlamentare dhe Dokumentacionin, që u krijua si një nismë e Konferencës së Kryetarëve të Parlamenteve.

iv. Objektivat dhe arritjet e bashkëpunimit parlamentar dhe diplomacisë parlamentare

Diplomacia parlamentare gjeti strehën e saj të parë në asambletë që janë pjesë e organeve ndërkombëtare. Ata u krijuan me qëllim që t'i japin një orientim politik dhe për të ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e këshillave të ministrave, si dhe organeve të specializuara.

Asambletë i kanë përdorur strukturat e tyre në përcaktimin dhe zhvillimin e kontakteve në fusha të ndryshme që janë pjesë integrale e përgjegjësiave të tyre. Fuqia e tyre lidhet me aftësinë për të miratuar dokumente të ndryshme, deri në kufijtë që e lejojnë procedurat, të cilat mund t'u transmetohen institucioneve të tjera. Përveç faktit që tekstet e përshtatura përbëjnë një ndihmesë të dobishme në punën përgatitore dhe në formimin e opinionëve për vendimmarrjen, ato, gjithashtu, dërgojnë sinjale politike që nuk duhet të nënvleftësohen.

Asambletë parlamentare janë, gjithashtu, vende takimi jo vetëm për vendet anëtare, por edhe për përfaqësues të vendeve të asociuara, partnere, vëzhguese ose të ftuar të veçantë. Është kjo natyrë organizimi që ka krijuar një terren unik dhe jo rrallë ka hapur rrugën e komunikimit ndërmjet shumë vendeve dhe, për rrjedhojë, ka sjellë kontakte të shumta ndërmjet vendeve që normalisht nuk do t'i kishin.

Në Europë, rasti i Britanisë së Madhe mund të citohet si një shembull i mirë. Ndërsa ajo mbeti jashtë Komunitetit European, ajo ishte në gjendje të mbante dialogun e vazhdueshëm parlamentar për shumë vite me vendet e tjera, në asambletë e NATO-s, BEP-it ose të Këshillit të Europës.

Kjo formë kontakti ndihmoi në krijimin e një opinionimi kolektiv në favor të arritjes dhe stabilizimit të marrëdhënieve të reja me Komunitetin European. Sot, vendet e Europës Lindore dhe të Mesdheut janë në një situatë të ngjashme, ndërsa ato presin në zgjerimin e institucioneve të tilla, siç është BE-ja ose NATO-ja, zgjerim që tashmë është një realitet për të dyja këto organizata.

Puna e bërë në komisionet e specializuara të çdo asambleje, i jep mundësinë parlamentarëve që të mësojnë më shumë nga njëri-tjetri dhe të vlerësojnë opinionet e homologëve të tyre në organizma të ndryshëm. Një pjesë e rëndësishme e gjithë veprimtarisë diplomatike është synimi i konsensusit në çështjet që diskutohen dhe në shkëmbimin e pikëpamjeve. Rezultatet reflektohen më tej në politikat kombëtare nëpërmjet marrëdhënieve konvencionale që ekzistojnë ndërmjet parlamenteve dhe

qeverive. Për shembull, Asambleja Parlamentare e BEP-it, e krijuar në vijim të traktateve të modifikuara të Brukselit të vitit 1954, përbën një model të një asambleje ndërkombëtare të krijuar shprehimisht si një forum i qëndrueshëm këshillimi. Ajo bashkon përfaqësues të vendeve anëtare me synim monitorimin e politikave të ndryshme qeveritare, si dhe përgatitjen e terrenit për debate mbi politikat e përbashkëta europiane të sigurisë dhe mbrojtjes.

Me kalimin e kohës, kjo Asamble ka shërbyer për krijimin e lidhjeve ndërmjet vendeve që, megjithëse i përkasin të njëjtit rajon gjeografik, nuk janë të gjitha anëtare të të njëjtave organizata politike. Ajo ka ndikuar mbi qeveritë, parlamentet, opinionin publik, për të gjeneruar dëshirën dhe vullnetin politik, thelbësor për zhvillimin e Mbrojtjes Europiane dhe Sigurisë dhe që sot ka prodhuar rezultate konkrete.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka gjetur tashmë një mënyrë për të krijuar një lidhje me parlamentet kombëtare. Ajo fton gjithnjë një delegacion parlamentar nga secili vend anëtar, për të marrë pjesë në sesionet plenare. Përveç qarkullimit të informacionit lidhur me veprimtaritë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, është krijuar një rrjet kontaktesh ndërmjet qeverive dhe delegacioneve parlamentare. Këto kontakte janë me të vërtetë të çmuara, ose të paktën të dobishme për verifikime të nevojshme të pozicioneve ose qëndrimeve të vendeve të ndryshme.

Veprimtaria e përbashkët me IPU-në është në po të njëjtën linjë. Gjithnjë e më tepër kontaktet ndërmjet OKS-së dhe IPU-së po formalizohen. Po kështu, gjithnjë e më tepër po flitet, ndonëse ende jo zyrtarisht, për transformimin natyror të IPU-së në asamble parlamentare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Deri tani marrëdhëniet ndërmjet këtyre organizatave janë rregulluar me deklaratatë të përbashkëta të sekretarëve të përgjithshëm përkatës, të cilat, ndonëse në formën e një *joint statement for cooperation*, mund të thuhet se përbëjnë bazën nga një avancim i këtyre marrëdhënieve. Dëshmi ishte

dhe Samiti i fundit i OKB-së për fëmijët, ku përveç deklaratës përfundimtare të kryetarëve të shteteve dhe të qeverive, pati dhe një deklaratë të Forumit të Parlamentarëve për Fëmijët.

Në asamblatë europiane ka pasur, gjithashtu, programe që kanë synuar në ngritjen e grupeve të punës, me synim studimin e problemeve në nivel shumëpalësh. Fusha në të cilën janë marrë një sërë nismash është ajo e marrëdhënieve ndërrajonale, me pjesëmarrjen e të ftuarve nga vende të tjera të interesuara.

Vlen të përmendet nisma “Rose-Roth”. Ky program filloi në Kongresin e SHBA-së në vitin 1990, me qëllim mbështetjen e pjesëmarrjes së parlamentarëve nga vendet e Europës Lindore, në veprimtaritë e Asamblesë Parlamentare të NATO-s. Disa dhjetëra veprimtari e seminare janë mbajtur lidhur me çështje të interesit të përbashkët, me objektiva të deklaruara, për të krijuar dhe mbështetur frymën e partneritetit dhe të mirëkuptimit ndërmjet anëtarëve të parlamenteve, shpërndarjes së informacionit dhe krijimit të kushteve, për të arritur në marrëveshje lidhur me çështje të rëndësishme për zhvillimin e marrëdhënieve demokratike.

Parlamenti European ka lançuar herë pas here nisma në fushën e diplomacisë parlamentare, ndërmjet të cilave ka qenë ajo e “procesit Royaumount”. Kjo nismë ishte në vijim të Marrëveshjeve të Dayton-it. Ajo u krijua me synim forcimin e lidhjeve dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë ndërmjet vendeve të Europës Juglindore. Në kuadër të këtij programi janë zhvilluar shkëmbime të vazhdueshme ndërmjet parlamentarëve të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të rajonit të EJL-it, si dhe shkëmbime të stafeve parlamentare dhe të informacionit.

Një program të ngjashëm ka Forumi Parlamentar Mesdhetar i Përhershëm, që gjithashtu adreson probleme rajonale. Ai mbledh së bashku parlamentet e vendeve që nënshkruan Marrëveshjen e Barcelonës, me synim arritjen e konsensusit në çështje të ndryshme me interes të përbashkët në rajonin e Detit Mesdhe.

Italia, që është veçanërisht aktive në Forum, organizon një konferencë vjetore me partnerët e saj, në të cilën rezultatet e punës së bërë nga grupet e ndryshme të punës debatohen përpara se t'i përcillen qeverive përkatëse. Konferenca e vitit 1999 e Palma de Majorkës, miratoi deklaratën e bashkëpunimit parlamentar euro-mesdhetar. Qëllimi kryesor i kësaj deklaratë ishte të inkurajojë zhvillimin e dialogut parlamentar, si shprehje e ndryshimit dhe ndërgjegjësimit të karakterit të bashkësisë së bashkuar tashmë nga vlerat politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

Parlamentet kombëtare u zotuan të marrin masa për krijimin e zonave të lira tregtare, nxitjen e politikave sociale të përbashkëta dhe shpejtimin e marrëveshjeve dypalëshe në këto fusha. Programi i dha gjithashtu jetë krijimit të Forumit të Grave Parlamentare dhe Forumit të Anëtarëve të Rinj të parlamenteve. Një nismë kjo e fundit e ndërmarrë ose më mirë e mbështetur dhe nga Parlamenti European në vendet e Europës Juglindore.

Asambleja Parlamentare e OSBE-së është specializuar edhe në monitorimin e zgjedhjeve, por në një kontekst më të gjerë, që përfshin ruajtjen dhe forcimin e vlerave demokratike, siç janë respekti për të drejta civile dhe forcimi i institucioneve përfaqësuese të popullit. Parlamentarët nga delegacione kombëtare, të cilat jo rrallë përfshijnë dhe anëtarë të komisioneve të politikës së jashtme të vendeve anëtare, monitorojnë rregullisht fushata zgjedhore dhe procedurat e votimit, por dhe çështje që lidhen me funksionimin e demokracisë dhe shtetin ligjor.

Delegacionet e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së kanë kryer, gjithashtu, misione ndërmjetësimi në rajone të përfshira në konflikte, të cilat kanë qenë veçanërisht të dendura në dhjetë vitet e fundit. Ato e kanë bërë këtë duke dërguar misione në zonat problematike dhe, në shumë raste, duke ofruar garanci të vëzhgimit të të drejtave themelore, me synim rikthimin e dialogut aty ku ka munguar.

Asamble të tjera, siç është Asambleja Parlamentare e BSEC-ut ose Asambleja Ndërparlamentare Konsultative e BENELUX-it, janë aktive

veçanërisht në nivel ndërrajonal. Ato kanë krijuar grupe pune të specializuara, me synim harmonizimin e legjislacionit dhe të procedurave administrative në fusha të interesit të përbashkët, siç është mjedisi, transporti, taksimi dhe marrëdhëniet ndërkufitare.

v. Informacion dhe raporte mbi veprimtaritë e mbuluara nga diplomacia parlamentare

Nga natyra, veprimtaritë në sferën e diplomacisë parlamentare nuk mund të klasifikohen në përputhje me një sistem të uniformizuar, veçanërisht po të kihet parasysh numri i konsiderueshëm i fushave që mbulohet nga ana tyre. Vetëm në asamblëtë ndërparlamentare puna organizohet në një mënyrë të tillë që të çon në miratimin e dokumenteve për të cilat votat janë në përputhje me procedurat parlamentare konvencionale.

Ato marrin formën e raporteve, të rekomandimeve, rezolutave, urdhrave ose vendimeve. Procesi që paraprin miratimin dhe përfundimin e teksteve të tilla përshkruhet në raportin zyrtar, i cili përmban një përmbledhje të debatit të zhvilluar. Në këtë mënyrë, dëshira e përbashkët e parlamentarëve merr shprehje në tekstet që i dërgohen qeverive, institucioneve dhe asambleve të tjera. Më tej ato mund të ndiqen për zbatueshmërinë e tyre në nivel kombëtar.

Megjithëse shpesh nuk ka ndonjë lidhje të dukshme ndërmjet këtyre dokumenteve, ato, sidoqoftë, përbëjnë tregues të besueshëm për të ndikuar zgjedhjet e ndryshme të politikave kombëtare, të cilat, nga ana e tyre, mund të reflektojnë zgjidhje që janë negociuar në kuadër të diplomacisë parlamentare.

Në funksion të këtij arsyetimi, është e qartë se ka disa fusha të cilat janë në mënyrë natyrore me të përshtatshme. Kjo veçanërisht për çështje që lidhen me marrëdhëniet dypalëshe, të cilat zhvillohen si rezultat i shqetësimeve të veçanta. Ndërsa çështjet që lidhen me marrëdhëniet shumëpalëshe vuajnë nga njëfarë mungese të mekanizmave të vendimmarrjes dhe ndonjëherë

dhe nga dublikimi. Nuk ka dyshim që konvergjenca dhe bashkëpunimi janë thelbësore në shoqëritë e sotme, kur problematika gjithnjë e më shumë po i kalon kufijtë shtetërorë të vendeve të ndryshme.

Ka një çështje që është vërtet për të ardhur keq, ajo e mosnjohjes nga masa e gjerë e publikut e veprimtarive të asambleve parlamentare. Edhe media nuk vihet në lëvizje për veprimtaritë e tyre, përdërisa parlamentarët nuk bëjnë sa duhet ose, në rastin më të keq, nuk tentojnë të përcjellin veprimtari të asambleve parlamentare.

vi. Konkluzione të përgjithshme

Tashmë nuk mund të mendohet që parlamentet të fokusohen në çështje që i përkasin vetëm politikës kombëtare dhe t'ia lënë qeverive gjithçka lidhet me vendime ose implikime më të gjera. Nëse do të bënin kështu, ato do të hiqnin dorë nga të qenurit përfaqësues të popullit, duke mos bërë gjë tjetër përveçse ratifikimin e vendimeve dhe duke e lënë veten jashtë diskutimit dhe pjesëmarrjes në problematikën reale.

Nga ana tjetër, me pretekstin e kujdesit dhe të rishikimit të interesave të veçantë të sektorëve të ndryshëm të shoqërisë, vetëm e vetëm për ta vendosur veten e tyre në “kompeticion” me ekzekutivin, nuk do t'i shërbente qëllimeve të parlamentarëve, por ndoshta përfitimit në marrëdhëniet e tyre me elektoratin.

Në një situatë të barazpeshuar kushtetuese dhe në gjendje t'iu përgjigjen ndryshimeve që ndodhin në shoqëri, parlamentarët duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre për të interpretuar kërkesat e zgjedhësve dhe për t'i përcjellë ato në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke synuar gjithnjë paanësi dhe propozime për zgjidhje praktike në nivel kombëtar.

Nuk ka dyshim se institucionet që janë në pozitë me të favorshme për të plotësuar këta kërkesa, janë asamblatë ndërkombëtare. Ato mbledhin në një forum delegacionet parlamentare që janë anëtare të asambleve kombëtare

dhe që kanë për detyrë të sigurojnë rrugë me dy kalime për shkëmbimin e informacionit ndërmjet elektoratit, parlamenteve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare. Ato janë mjeti i duhur për paraqitjen e rezultateve të debatit ndërkombëtar në parlamentet kombëtare, duke plotësuar debatin kombëtar me pasurinë e ekspertizës dhe të propozimeve praktike që vijnë nga asamblatë ndërkombëtare.

Nismat në këtë fushë duhen të nxiten në kuadrin e qëllimit të dobishëm që ato shërbejnë, në veçanti, duke forcuar organizata e shërbime mbështetëse për përqendrimin e përpjekjeve, përmirësimin e kontakteve të rrjeteve, shmangien e shkaqeve që krijojnë probleme dhe parandalimin e fragmentizimit.

vii. A ka Shqipëria një profil në diplomacinë parlamentare?

Shqipëria, në fillim të viteve '90, filloi të marrë pjesë në forumet ndërparlamentare. Ndonëse ishte anëtare e IPU-së, roli dhe pjesëmarrja e saj në këtë forum ka qenë pothuaj "figurative", për të mos thënë e paqenë. Aspiratat për integrim në strukturat euroatlantike bënë që Shqipëria të kërkonte avancimin e statusit të saj kryesisht në organizatat eurpiane që kanë asamble parlamentare. Kështu, deri në vitin 1995, që shënon anëtarësimin e Shqipërisë në Këshillin e Europës, pjesëmarrja më substanciale ka qenë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, Praktikisht, punimet kësaj Asambleje dhe çështjet e diskutuara atje, si rrallë në ndonjë vend tjetër, kanë qenë pjesë thelbësore e debatit publik dhe atij politik në Parlamentin Shqiptar.

Në të njëjtën kohë, mund të thuhet se Shqipëria është anëtare aktive e Nismës së Mesdheut, të asaj të Europës Qendrore, si dhe të Nismës së Bashkëpunimit Ekonomik në rajonin e Detit të Zi.

Ndonëse Bashkimi Ndërparlamentar është një organizatë pothuaj globale, Shqipëria, për arsye nga më të ndryshmet, ka qenë vazhdimisht e pranishme e aktive, arsye këto ndoshta jo shumë të lidhura me debatin normal që zhillohet në IPU.

Në Asamblenë e Atlantikut Verior, Shqipëria ka një histori pothuaj unike, sepse ajo fitoi statusin që ka edhe sot, duke superuar të gjitha procedurat. Në mbledhjen e Berlinit të kësaj Asambleje, delegacioni shqiptar shfrytëzoi në mënyrë mjeshtërore marrëdhëniet shumë të mira të vendosura me udhëheqësin e kësaj Asambleje. Gjithashtu, Shqipëria ka qenë mjaft aktive në kuadrin e veprimtarive të zhvilluara rreth nismës “Rose Roth”.

Marrëdhëniet me Parlamentin Europian janë të institucionalizuara dhe realizohen me takimet vjetore të Delegacionit të Parlamentit Europian për Europën Juglindore dhe të Delegacionit Parlamentar Shqiptar për marrëdhëniet me Parlamentin Europian. Natyrisht, me avancimin e marrëdhënieve, angazhimi i Parlamentit në të gjithë debatin dhe problematikën e stabilizim-asociimit merr një rëndësi tjetër, veçanërisht kjo lidhur me nevojën e harmonizimit të legjislationit, si dhe të përbushjes së angazhimeve dhe të detyrimeve të Shqipërisë përballë institucioneve të BE-së. Ky rol ka një komponente konkrete afatshkurtër që prek problematikën e mprehtë në luftën kundër korrupsionit, zgjidhjen që do i jepet çështjes së pronësisë, reformës në administratën publike, reformës zgjedhore dhe, e fundit, por ndoshta më e rëndësishmja, marrja e duhur e rolit kushtetues të Parlamentit në kontrollin mbi ekzekutivin dhe zbatueshmërinë e ligjit.

Parlamenti ka, gjithashtu, një rol të veçantë në ndihmesën që duhet të japë në procesin e negociimit të marrëveshjes së stabilizim-asociimit. Ky proces nuk mund të mendohet si një ekskluzivitet i Qeverisë. Një negociim i barazpeshuar do të angazhonte në çdo hap ligjvënësit, për të mënjeluar të papriturat dhe inkoherencën e vendimeve.

Shqipëria është, gjithashtu, nismëtare e procesit të ngritjes së një asambleje parlamentare të vendeve të Europës Juglindore. Nisma të tilla, në një këndvështrim sado të shkurtër ose të largët historik, vijnë si rrjedhojë e vendimeve që merren në nivel ekzekutiv. Kështu, në “rrjedhën normale” këto zhvillime duhet të vinin nga një forum ekzekutiv i këtyre vendeve. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende dhe duket se kjo nismë do të ndiqte, ose ndjek

një rrugë të ndryshme, nisur dhe nga investimi vetjak i Kryeministrit të Shqipërisë, që më shumë se një herë, me tone jo të pakta kritike, i ka kërkuar diplomacisë shqiptare që të vihet në lëvizje lidhur me këtë çështje.

Ky përafrim deri këtu duket normal, në sensin që është më se normale që një kryetar qeverie të angazhohet në inicimin e një procesi, që, në thelb, nuk mund të jetë veçse pozitiv dhe, në rastin më të keq, do të ndikojë në rritjen e komunikimit të munguar ndërmjet ligjvënësve ose përfaqësuesve të popullit të vendeve të rajonit tonë. Nga ana tjetër, ky proces mund të ndihmojë në përshpejtimin e përafrimit të legjislationit të vendeve të rajonit, fillimisht në çështje që lidhen me proceset integruese europiane dhe, më tej, në trajtimin me një gjuhë të përafërt, në mos të njëjtë ligjore, të të gjithë problematikës që lidhet me luftën kundër trafikeve, krimin të organizuar që, për hir të së vërtetës duhet thënë, po merr gjithnjë e më shumë profil rajonal, si dhe të gjithë problematikës që lidhet me sigurinë dhe rendin. Mirëpo, nëse e konsiderojmë si legjitim shqetësimin e Kryeministrit për mospërgjigje adekuate të diplomacisë në formën klasike, në çuarjen përpara të kësaj nisme, këtu mund të kishte dhe ka një rol të qartë për diplomacinë parlamentare. Në rastin konkret, vënia në lëvizje e parlamentarëve do të kërkonte një projekt konkret, ku konturet e bashkëpunimit dhe gjithçka që lidhet me formatin ose vizionin e një asambleje të tillë të ishin të mirëdefinuara.

Natyrisht, në jetën parlamentare dhe në veprimtarinë e Parlamentit ka elemente gjithnjë në rritje të angazhimit në veprimtari që mund të konsiderohen të mirëfillta të diplomacisë parlamentare. Nuk mund të thuhet se ka një vetëdije të plotë për rolin e saj dhe se ajo është pjesë e planeve të veprimit ose e vizionit të punës së komisioneve parlamentare, e vetë shërbimeve të Parlamentit, si dhe në veprimtarinë e Komisionit të Politikës së Jashtme të Parlamentit.

Disa shënime në lidhje me Statutin e Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare

*Ditmir Bushati, LL.M.
Këshilltar Juridik në Gjykatën Kushtetuese*

1. HYRJE

Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet ligjit nr. 8984, datë 23.12.2002 “Për ratifikimin e Statutit të Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare” ka ezauruar në mënyrë procedurale anëtarësimin e Shqipërisë në këtë Statut, duke përmbushur vullnetin e shprehur nga ana e Republikës së Shqipërisë me nënshkrimin e Statutit në Romë më 18 korrik 1998¹.

Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare (më poshtë “GJPN”) konsiston në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër krimeve të rënda që kërcënojnë paqen, sigurinë, integritetin territorial, pavarësinë dhe mirëqënien e bashkësisë ndërkombëtare, si dhe në ndjekjen efektive të tyre. Kjo, nëpërmjet marrjes së masave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me objektivin, që të kontribuojnë në parandalimin e krimeve të tilla.

Ky Statut, i nënshkruar nga 120 shtete dhe i ratifikuar afërsisht nga 90 prej tyre, përfaqëson themelimin përmes një traktati ndërkombëtar të së

¹ Ratifikimi i Statutit të Romës nga shtetet europiane është nxitur edhe përmes rekomandimit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës (rekomandimi 140 i vitit 1999) dhe Rezolutës së miratuar nga Parlamenti European (EU Bulletin 12-1999).

parës gjykatë të përhershme me seli në Hagë, e cila do të promovojë sundimin e ligjit, duke siguruar përmes një juridiksioni sa më universal, se krimet e rënda ndërkombëtare që kanë tronditur njerëzimin nuk do të mbeten pa u ndëshkuar në të ardhmen. Ashtu siç parashikohet nga neni 126 i Statutit, ky Statut ka hyrë në fuqi që nga 1 korriku i vitit 2002, pas ratifikimit nga 60 shtete pjesëmarrëse në Samitin e Romës.

Problematika në lidhje me këtë traktat ndërkombëtar është e larmishme, por analiza e mëposhtme fokusohet në treguesit historikë dhe nevojën për të pasur një institucion të tillë, në juridiksionin dhe mungesën e përkufizimit për krimin e agresionit, parimin e komplementaritetit dhe disa çështje kushtetuese që kanë të bëjnë me përputhshmërinë e disa dispozitave të Statutit me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

2. TREGUESIT HISTORIKË DHE NEVOJA PËR KRIJIMIN E GJPN-SË

Ideja për krijimin e një gjykate ndërkombëtare me autoritet të detyrueshëm për të gjithë nuk është ide e ditëve të sotme. Qysh në “Konferencën e Parë të Paqes” të zhvilluar në Hagë më 1899, Elihu Root, themelues dhe President i Shoqatës Amerikane për të Drejtën Ndërkombëtare, njëkohësisht, Sekretar Shteti i SHBA-së, u bë nismëtar i idesë së ngritjes së një gjykate ndërkombëtare. Presidenti i SHBA-së Theodore Roosevelt, në një mesazh drejtuar Kongresit, e konsideronte këtë propozim si “hap përpara që e çon botën drejt sundimit të ligjit dhe arsyes”. Në të njëjtën linjë shfaqej asokohe edhe Britania e Madhe, e cila, e kushtëzuar nga rrethanat e kohës, e shihte si zgjidhje adeguate krijimin e një gjykate ndërkombëtare. Mirëpo, shtetet pjesëmarrëse në Konferencë nuk gjetën konsensusin e nevojshëm për rregullat mbi bazën e të cilave do të funksiononte gjykata.

Në një fjalim të mbajtur më 17 dhjetor 1919, Presidenti i SHBA-së, Howard Taft, e konsideronte krijimin e gjykatës ndërkombëtare “si metodën

më të mirë për zgjidhjen e kontraditave sesa luftën”. Në fakt, nevoja për një gjykatë penale ndërkombëtare ishte evidente që në 1914, pas vrasjes së Dukës Ferdinand të Austrisë nga nacionalistët serbë. Por, në vend të ngritjes së një institucioni ligjor, shtetet preferuan luftën². Vetëm një vit më vonë, Franca, Britania e Madhe dhe Rusia denoncuan masakrat ndaj minoritetit armen në Turqi si “krime kundër njerëzimit”. Protestat diplomatike u injoruan nga ana e Turqisë e për pasojë, asnjë person përgjegjës nuk u gjykua.

Pas vrasjes së Mbretit Aleksandër të Jugosllavisë më 1934, Franca propozoi hartimin e një kodi penal ndërkombëtar dhe krijimin e një gjykate ndërkombëtare për të ndëshkuar terroristët. Propozimi erdhi si pasojë e frikës për fillimin e një lufte tjetër botërore³. Në këtë periudhë u miratuan dy Konventa (njëra për terrorizmin dhe tjetra për krijimin e gjykatës penale ndërkombëtare), por asnjë shtet nuk pranoi të ratifikonte Konventën që bënte fjalë për krijimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare⁴. Kësisoj, asnjëra nga Konventat nuk hyri në fuqi.

Dorëzimi pa kushte i udhëheqësve nazistë në 1945 i hapi rrugë krijimit ligjor të Tribunalit Ushtarak Ndërkombëtar të Nurembergut. Megjithëse u nevojiti shumë kohë dhe mund për të ardhur në jetë, Nurembergu ishte vetëm fillesa e një procesi historik të pandalshëm⁵. Themelimi i këtij institucioni u shoqërua natyrshëm me reagime të ndryshme, duke u konsideruar madje

² Shih për këtë argument B. Ferencz,

Misguided Fears About the International Criminal Court , 1 PILR 10 (2003).

³ Duhet mbajtur parasysh se vrasja e Dukës Ferdinand shërbeu si zjarrnxitëse për fillimin e Luftës së I Botërore.

⁴ Vetëm India ratifikoi Konventën mbi Terrorizmin.

⁵ Përpjekje simbolike për të sjellë para drejtësisë kombëtare ose ndërkombëtare kryetarë shtetesh ose zyrtarë të lartë ka pasur edhe para Nurembergut. Kështu, neni 227 i Traktatit të Paqes së Versajës që u aktivizua ndaj Williamit II bënte fjalë “për shkelje të rënda kundër moralitetit ndërkombëtar dhe të traktateve ndërkombëtare”. Ndërkohë, Gjykata e Lartë Gjermane në Leipzig, duke u bazuar në nenin 228 gjyko personat e akuzuar për krime lufte.

edhe si një “instrument i dhënies së drejtësisë nga aleatët”. Por, me gjithë gamën e gjerë të problemeve që paraqiste koha, përvoja e Nurembergut u konsiderua gjerësisht udhërrëfyese për sistemet kombëtare, tribunalet e mëvonshme *ad hoc* të themeluara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe vetë GJPN-në⁶.

Përpjekjet për të zhvilluar e forcuar një sistem efektiv të përgjegjësisë ndërkombëtare për shkeljet e të drejtave të njeriut janë intensifikuar, sidomos në dekadën që lamë pas. Si pikënisje e kësaj periudhe të re konsiderohet themelimi nga ana e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të tribunaleve penale ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën në 1993 dhe 1994, dhe, së fundmi, themelimi i tribunalit për Sierra Leonen.

Duke pasur një juridiksion të kufizuar vetëm mbi shtetet në të cilat kishte shpërthyer konflikti i armatosur, këto përvoja, sado të vyera, treguan pamjaftueshmërinë e instrumenteve dhe mekanizmave ekzistues të së drejtës ndërkombëtare për të shmangur krimet që vënë në rrezik paqen dhe sigurinë botërore, të parashikuara edhe nga vetë dispozitat e Kartës së OKB-së.

Kështu, neni 1 (1) i Kartës parashikon se qëllimi i Kombeve të Bashkuara është ruajtja e paqes kolektive dhe e sigurisë ndërkombëtare dhe në këtë drejtim, marrja e masave të frytshme për parandalimin dhe shmangien e kërcënimeve të paqes dhe ndjekjen e çdo akti agresioni ose prishjeje të paqes, duke realizuar me mjete paqësore dhe në përputhje me parimet e drejtësisë dhe të së drejtës ndërkombëtare zgjidhjen a rregullimin e mosmarrëveshjeve ose të situatave me karakter ndërkombëtar që mund të çojnë në prishjen e paqes.

Në ndryshim nga institucionet e mëparshme të drejtësisë, të cilat qenë të

⁶ Është e rëndësishme të përmendet që përvoja e Nurembergut u pasua nga proceset gjyqësore të ngjashme që u zhvilluan në Tribunalin Ushtarak Ndërkombëtar të Tokios.

karakterit rajonal⁷, GJPN-ja që s’lindi në zbrazëti, ofron zgjidhje jo të përkohshme, më të plotë, më solide dhe me një juridiksion sa më universal. Në një farë mënyre, Statuti i Romës plotëson “aksiomën” e shprehur nga prokurori i dalluar Benjamin Ferenz që në gjyqin e Nurembergut se “*nuk mund të ketë paqe pa drejtësi, nuk mund të ketë drejtësi pa ligj dhe nuk mund të ketë ligj në kuptimin e vërtetë të fjalës pa një gjykatë që të vendosë se çfarë është e drejtë dhe e ligjshme në çdo rrethanë të caktuar*”.

Në këtë kontekst, GJPN-ja synon të jetë organ qendror i mekanizmave shtërngues të sistemit penal ndërkombëtar. Vrojtuar nga optika e së drejtës ndërkombëtare, krijimi i GJPN-së përmes traktatit ndërkombëtar heq çdo hije dyshimi në lidhje me bazën ligjore të themelimit, në ndryshim nga krijimi i tribunaleve *ad hoc*, themelimi i të cilave u bazua në rezolutat e Këshillit të Sigurimit.

3. JURIDIKSIONI

Sipas nenit 5 të Statutit të Romës, në kategorinë e krimeve mbi të cilat GJPN-ja do të ushtrojë juridiksionin përmenden:

- Krimi i genocidit
- Krimet kundër njerëzimit
- Krimet e luftës
- Krimi i agresionit

Krahasuar me normat e reflektuara në të drejtën ndërkombëtare, Statuti

⁷ Për shembull, Tribunalet *ad hoc* të themeluara për konfliktet e ndryshme, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, Gjykata Europiane e Drejtësisë. Madje, edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e cila gëzon juridiksionin të kufizuar për mosmarrëveshjet që lindin mes shteteve, ka qenë më e ngarkuar nga sa mendohej, me vendimet dhe opinionet këshillimore, që kanë përfshirë që nga interpretimet për Konventën për Parandalimin dhe Ndëshkrimin e Krimit të Gjenocidit, deri të ligjshmëria e përdorimit të armëve bërthamore.

i Romës parashikon një listë të ngushtë krimesh⁸. Kjo, për faktin, se shumë delegacione shtetërore në Samitin e Romës dëshironin një përcaktim të përpiktë dhe koherent për krimet, në mënyrë që të ishin në pajtim me standardet e së drejtës penale ndërkombëtare e në të njëjtën kohë, të siguronin në praktikë respektimin e parimeve të plazmuara *nullum crimen sine lege* dhe *nulla poena sine lege*. Nga ana tjetër, duke e kufizuar juridiksionin e GJPN-së vetëm te krimet e lartpërmendura, të njohura gjerësisht nga praktika e së drejtës ndërkombëtare, u bë e mundur që përmbajtja e Statutit të Romës të përqafohej nga shumica e shteteve⁹.

GJPN-ja mund të ushtrojë juridiksionin e saj në lidhje me krimin e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, vetëm kur krimi është kryer në territorin e një shteti palë në Statut ose kur personi që ka kryer krimin mban nënshtetësinë e shtetit palë në Statut.

GJPN-ja do të ushtrojë juridiksion për krimet e agresionit, kur të arrihet një marrëveshje e pranuar nga e drejta ndërkombëtare, në lidhje me përkufizimin e këtij krimi në të ardhmen¹⁰.

⁸ Shih për këtë argument: L. S. Sunga, *The crimes within the Jurisdiction of the International Criminal Court (Part II, Articles 5-10)*, 6/4 EJC 378 (1998). Në fakt, Komisioni i të Drejtës Ndërkombëtare në faza të ndryshme të hartimit të Statutit të Romës kishte zgjeruar rrethin e krimeve me figura të tilla si: zotërimi kolonial, ndërhyrja, rekrutimi, përdorimi dhe financimi i mercenarëve, terrorizmi ndërkombëtar, trafiku i paligjshëm i lëndëve narkotike etj.

⁹ Id. Poshtëshënimi paraardhës. Një shqetësim i tillë është ngritur nga shumë shtete gjatë komenteve të bëra për Projekt-Kodin e Krimeve kundër Paqes dhe Sigurisë Ndërkombëtare, të hartuar nga Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare në vitin 1991. Në përgjigje të komenteve të marra, Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare e ngushtoi në mënyrë radikale gamën e krimeve, të përfshira në variantin e përgatitur në vitin 1996.

¹⁰ Shih më gjerë për këtë argument: G. M. Dawson, *Defining Substantive Crimes within the Subject Matter Jurisdiction of the International Criminal Court: What is the Crime of Aggression?*, 19 NYLSJICC 413-449 (2000). Madje, Asambleja e Shteteve Palë në Statut ka krijuar një nënkomision për të përpunuar përkufizimin për krimin e agresionit. Nënkomisioni pritet të bëjë propozimet e tij në shkurt të 2003. Nëse shtetet bien dakord, atëherë do të nevojitet amendimi i Statutit, në pajtim me dispozitat e tij, në mënyrë që GJPN-ja të ushtrojë juridiksionin e vet.

Nga këndvështrimi historik, është zhgënjyese pamundësia e shteteve për të pranuar konkluzionet e Nurembergut për përkufizimin e krimit të agresionit¹¹. Gjithsesi, është për t'u shënuar fakti se Statuti i Romës, në mënyrë eksplicite, kërkon që çdo përkufizim i mundshëm për krimin e agresionit të jetë në përputhje me Kreun VII e më specifikisht me nenin 39 të Kartës së OKB-së. Formula e ofruar garanton rolin primar të Këshillit të Sigurimit në përcaktimin e situatave të tilla.

GJPN-ja mund të investohet nga Prokurori i GJPN-së, nga një shtet anëtar i Statutit ose nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Prokurorit i duhet autorizimi i një trupe gjyqësore, të përbërë prej tre gjyqtarësh, për të filluar procedimin penal. Vendimi i trupës mund të apelohej te një tjetër trupë e përbërë prej pesë gjyqtarësh. Gjithashtu, Këshilli i Sigurimit të OKB-së mund të pushojë procedimin kur çmohet se pengon negociatat për paqe që mund të zhvillohen për një zonë të caktuar. E njëjta procedurë vlen edhe në rastet kur çështja i referohet Prokurorit nga ana e një shteti palë në Statut. Ndërsa, kur çështja i referohet Prokurorit nga Këshilli i Sigurimit, GJPN-ja mund të ushtrojë juridiksionin e vet në mënyrë të pakufizuar.

Investimi i GJPN-së nga Prokurori ose shtetet palë mbetet subjekt i kontrollit dhe procedurave të sakta. Ka autorë që mendojnë se “asnjë prokuror në historinë e njerëzimit nuk ka qenë subjekt i kaq shumë parakushteve sa këto që parashikon Statuti i GJPN-së”¹². Ndërsa, Henry Kissinger, kritik ndaj doktrinës së juridiksionit universal në përgjithësi e GJPN-së në veçanti, mendon se “mungesa e kontrollit ndaj Prokurorit dhe diskrecioni i pakufizuar

¹¹ Me nismën e amerikanëve, agresioni ose krimet kundër paqes ishin përfshirë në listën e krimeve në Kartën e Londrës për gjyqin e Nurembergut dhe u rikonfirmuan nëpërmjet vendimeve gjyqësore. Por, kjo figurë krimi nuk u përfshi në juridiksionin e tribunaleve ad hoc për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën.

¹² B. Ferencz, poshtëshënimi 2, 4.

i tij, përbëjnë të metat kryesore të GJPN-së”¹³.

Juridiksioni shtrihet mbi të gjithë personat fizikë që janë mbi 18 vjeç. Sipas Statutit, mbajtja e një posti zyrtar si kryetar shteti ose qeverie, anëtar qeverie, deputet ose zyrtar i rangut të lartë, nuk e shmang personin nga përgjegjësia penale. Neni 11 përcakton mungesën e *ratione temporis* për krime të kryera para hyrjes në fuqi të këtij Statuti. Kësisoj, është garantuar ndalimi i fuqisë prapavepruese të Statutit, i cili nuk do të kishte gjetur mbështetje tek parimi *nullum crimen sine lege*.

4. PARIMI I KOMPLEMENTARITETIT

Duke u bazuar në nenin 1 të Statutit, GJPN-ja krijohet si gjykatë plotësuese e juridiksionit penal kombëtar dhe në bazë të nenit 17 ka të drejtë të kërkojë në çdo fazë të hetimit ose gjykimit që çështja t’i kalojë për hetim ose gjykim. Kjo, kur shtetet e kanë të pamundur ose nuk dëshirojnë të hetojnë një çështje kundër nënshtetasve të tyre. Neni 17 i Statutit përcakton kriteret se kur një shtet nuk dëshiron të hetojë persona që dyshohen se kanë kryer krime që janë nën juridiksionin e GJPN-së.

Parimi i komplementaritetit përbën pa mëdyshje një ndihmesë kritike për forcimin e legjislacionit kombëtar dhe sistemin e drejtësisë, në mënyrë që këto krime të gjykohen në nivel kombëtar. Asnjë dispozitë e Statutit nuk pengon sistemet ligjore të shteteve të ndryshme nga marrja e përgjegjësive kryesore për të proceduar të gjithë ata persona që shkelin të drejtën

¹³ Shih për më gjerë, H. Kissinger, Does America Need a Foreign Policy? 281 (2002). Një arsyetim i ngjashëm është ofruar edhe nga Këshilli Kushtetues Francez, ku ndër të tjera thuhet se “Kompetenca e prokurorit, që ai të procedojë edhe jashtë rasteve kur aparati gjyqësor kombëtar është i padisponueshëm, në kryerjen e disa akteve hetimi, në marrjen e deponimeve ose në inspektimin e vendeve publike pa praninë e autoriteteve të shtetit dhe në territorin e këtij të fundit, ka natyrë të tillë që çënon kushtet thelbësore të ushtrimit të sovranitetit kombëtar” (Vendim nr. 98-408, datë 22.01.1999).

ndërkombëtare humanitare. GJPN-ja pritet të luajë një rol thelbësor në situata të ngjashme me ato të ish-Jugosllavisë ose Ruandës, ku personat e veshur me pushtet mbrojnë autorët e krimeve, ose në rastet kur sistemi ligjor i një shteti nuk është i aftë të përballojë një procedim efektiv¹⁴.

Në rastin e Shqipërisë, organizimi gjyqësor është i përcaktuar në Kushtetutë dhe në legjislacionin përkatës që rregullon fushën penale dhe procedurale penale, duke parashikuar gjykatat me juridiksion penal në Republikën e Shqipërisë. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me vendimin e saj nr. 186 ka theksuar *inter alia* se “Funksioni komplementar i GJPN-së ndaj juridiksionit gjyqësor penal vendas, ose edhe vendosja e dispozitave të Statutit në rendin e brendshëm juridik, nuk vijnë ndesh me Kushtetutën e konkretisht me nenin 135, ku përcaktohen rigorozisht organet e pushtetit gjyqësor në Shqipëri të krijuara me ligj, dhe ku përjashtohet në mënyrë kategorike krijimi i gjykatave të zakonshme¹⁵.

Duke vështruar këtë organizim të brendshëm në korrelacion me nenin 17 të Statutit të Romës, si dhe duke pasur në vëmendje përfundimet e Gjykatës Kushtetuese, mund të thuhet se GJPN-ja paraqitet si një gjykatë më tepër, e cila ka karakter plotësues përjashtimor dhe të kufizuar vetëm për katër llojet e krimeve të lartpërmendura që kanë karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

¹⁴ Shih për këtë argument, H. Fischer, Are there more effective mechanisms for promoting international justice? in A. Dworkin (Ed.), The United States and the International Criminal Court: A Briefing 5-6 (2002).

¹⁵ Neni 135 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë thotë:

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë të cilat krijohen me ligj.

2. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.

5. ASPEKTE KUSHTETUESE TË RATIFIKIMIT TË STATUTIT TË ROMËS

Fryma e Statutit të GJPN-së përçohet që në hyrjen e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se “Populli i Shqipërisë e ka vendosur këtë Kushtetutë me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit.”

Sipas parimit *pacta tertiis nec nocent nec prosunt*, i mishëruar në neni 34¹⁶ të Konventës së Vjenës “Mbi të Drejtën e Traktateve” të vitit 1969, deri në çastin e ratifikimit nga Republika e Shqipërisë, Statuti nuk ka vlerën e traktatit ndërkombëtar të detyrueshëm për vendin tonë. Megjithatë, po të lexojmë nenin 5 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë¹⁷, në lidhje me zbatimin e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për të, në korrelacion me nenin 5 të Statutit të Romës, që përcakton krimet që hyjnë brenda juridiksionit të GJPN-së, arrijmë në konkluzionin se këto krime, në optikën e vlerësimit të së drejtës ndërkombëtare, konsiderohen si detyrime *erga omnes*, për pasojë, janë të detyrueshme për të gjitha subjektet e së drejtës ndërkombëtare, edhe nëse nuk ekziston ndonjë *nexus* konvencional.

Duke pasur në vëmendje kërkesën e nenit 5 të Kushtetutës dhe nenin 38 të Konventës së Vjenës¹⁸ “Mbi të Drejtën e Traktateve” të vitit 1969, i cili parashikon se rregullat e një traktati bëhen të detyrueshme për shtetet e

¹⁶ Neni 34 i Konventës së Vjenës “Mbi të Drejtën e Traktateve” të vitit 1969 thotë:

“Një traktat ndërkombëtar nuk krijon as detyrime e as të drejta për një shtet të tretë pa pëlqimin e tij.”

¹⁷ Neni 5 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë thotë:

“Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”.

¹⁸ Neni 38 i Konventës së Vjenës “Mbi të Drejtën e Traktateve” të vitit 1969 thotë:

“Asgjë e parashikuar nga nenet 34 deri në 37 nuk pengon fuqinë e një rregulle të përfshirë në traktat ndaj një shteti të tretë, me kusht që ajo të jetë e njohur si e drejtë zakonore ndërkombëtare.”

treta për shkak të krijimit të një zakoni ndërkombëtar ose të marrjes së formës *jus cogens*¹⁹, mendoj se figurat e krimit të parashikuara në Statut janë të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

Ekziston një jurisprudencë ndërkombëtare e konsoliduar që bën të qartë dallimin ndërmjet detyrimeve të një shteti kundrejt bashkësisë ndërkombëtare në tërësi dhe atyre me karakter diplomatik që kanë shtetet ndaj njëri-tjetrit në fushën e mbrojtjes. Kuptohet, që për vetë natyrën e tyre, të parat i përkasin çdo shteti. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e të drejtave të përfshira në to, mund të thuhet se të gjitha shtetet kanë një interes të ligjshëm në mbrojtjen e tyre, pra, ato janë detyrime *erga omnes*. Këto detyrime, në të drejtën ndërkombëtare aktuale, rrjedhin nga ndalimi i akteve të agresionit, të genocidit, si dhe nga parimet dhe rregullat që kanë të bëjnë me të drejtat themelore të qenies njerëzore, përfshirë këtu mbrojtjen nga skllavëria dhe diskriminimin racial. Disa nga këto të drejta janë bërë pjesë integrale e korpusit të së drejtës ndërkombëtare²⁰.

¹⁹ Raporti i Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare (II Yearbook of International Law Commission, 247-48, 1966) sugjeron disa nga shembujt e normave të së drejtës ndërkombëtare që mund të kenë karakter *jus cogens*, si për shembull:

a) traktat që parashikon si të paligjshëm përdorimin e forcës në kundërshtim me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara;

b) traktat që ndalon çdo lloj akti tjetër të konsideruar si krim sipas së drejtës ndërkombëtare;

c) traktat që parandalon ose dënon akte të tilla si tregtia e skllëvërve, pirateria ose genocidi, në ndalimin e të cilëve çdo shtet është i lutur të bashkëpunojë.

²⁰ Për këtë mendim, shih, Barcelona Traction, Light and Power Company (Belgium v. Spain), 1970 ICJ Rep. para., 33-34. Shih, gjithashtu, Mendimin Këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në lidhje me Rezervat ndaj Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkrimin e Krimit të Gjenocidit, ICJ Rep. 1951. Edhe në mendimin e saj këshillimor në lidhje me Ligjshmërinë e Kërcënimit ose të Përdorimit të Armëve Bërthamore (ICJ Rep. 1996 - General list), Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konfirmoi faktin që parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare përbëjnë pjesë të *jus cogens* të tillë, siç parashikohet nga nenet 53 dhe 64 të Konventës së Vjenës “Mbi të Drejtën e Traktateve” të vitit 1969.

Në këtë kuadër, ratifikimi i Statutit të GJPN-së nga ana e Republikës së Shqipërisë duhet shikuar si një garanci shtesë përsa i përket parimit për një gjykim të drejtë, parashikuar nga nenet 29, 30, 31, 32, 33 dhe 34 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe interpretuar në korrelacion me nenet 16, 17 dhe 18 të saj.

6.1. ÇËSHTJA E IMUNITETIT TË PERSONAVE ZYRTARË

Në bazë të nenit 27 (1) të Statutit, GJPN-ja ka juridiksion ndaj të gjithë personave, pa asnjë dallim, të mbështetur në pozitën zyrtare²¹. Imunitetet ose rregullat speciale procedurale që mund t'i jenë bashkëngjitur pozitës zyrtare të personit, sipas së drejtës kombëtare ose asaj ndërkombëtare, nuk pengojnë GJPN-në nga ushtrimi i juridiksionit të saj mbi një person të tillë²².

Në të vërtetë, një formulim i ngjashëm gjendet edhe në instrumentet ndërkombëtare pararendëse²³. Përveç formulimit të instrumenteve ndërkombëtare, zhvillimet jurisprudenciale të renditura më poshtë, gjithëaq kanë mbështetur idenë e *mosgëzimit të imunitetit, kur kemi të bëjmë me shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare*.

²¹ Neni 27 (1) i Statutit të Romës thotë:

“Ky Statut do të zbatohet njësoj ndaj të gjithë personave, pa asnjë dallim, bazuar në pozitën zyrtare. Në veçanti, pozita zyrtare si kryetar i shtetit, i qeverisë ose parlamentit, përfaqësues i zgjedhur i qeverisë ose zyrtar i qeverisë, në asnjë rast nuk do të përjashtojë një person nga përgjegjësia penale sipas këtij Statuti, as ai nga vetja nuk mund të krijojë bazë për reduktimin e dënimit”.

²² Shih për këtë: Raporti “Çështje kushtetuese që rrjedhin nga ratifikimi i Statutit të Romës për GJPN-në” përgatitur nga Komisioni Europian për Demokracinë përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), 3 (2000).

²³ Neni 227 i Traktatit të Versajës; neni 7 i Kartës së Tribunalit Ushtarak të Nurembergut; neni 6 i Kartës së Tribunalit Ushtarak të Tokios; neni 7 (2) i Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë; neni 6 (2) i Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën).

· Dhoma e Lordëve refuzoi të njohë imunitetin e Pinoçetit²⁴

· Autoritetet jugosllave e kanë përdorur kartën e imunitetit të kryetarit të shtetit si pretekst për mosdorëzimin e Millosheviçit para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Ky argument u përdor gjerësisht edhe nga vetë Millosheviçi në seancat përgatitore të procesit, argument që nuk është pranuar nga Dhoma e Shkallës së Parë të Tribunalit²⁵

· Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen *Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë*²⁶ mban të njëjtin qëndrim, i cili duhet theksuar se ka vlerë interpretative kushtetuese për Republikën e Shqipërisë, në kuadrin e nenit 17 (2) të Kushtetutës.

· Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në çështjen *Kongo kundër Belgjikës* shprehet në mënyrë më eksplicite për këtë problem dhe shkon më tej, duke bërë dallimin mes juridiksionit të gjykatave kombëtare dhe imunitetit juridiksional²⁷.

Sipas Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, juridiksion nuk do të thotë mungesë imuniteti, ndërkohë që mungesë imuniteti nuk do të thotë juridiksion. Sado që instrumentet ndërkombëtare të sipërpërmendura vendosin detyrime mbi shtetet, për ta shtrirë juridiksionin penal, kjo nuk ndikon në imunitetin që gëzojnë personat zyrtarë në bazë të së drejtës zakonore ndërkombëtare. Mirëpo, ky imunitet nuk është i pakufizuar dhe për të gjitha llojet e krimeve.

²⁴ Shih, R v. Bow Street Metropolitan Stipendiary Magistrate, *ex parte* Pinochet Ugarte, 4 All E.R. ku Dhoma e Lartë e Mbretërisë së Bashkuar për mungesën e imunitetit u shpreh se "...një përfundim i kundërt do të ishte shmangie nga e drejta ndërkombëtare".

²⁵ Shih për më gjerë Prosecutor v. Slobodan Miloseviç, Case No. IT-02-54.

²⁶ Shih: Streletz, Kessler and Krenz v. Gjermanisë, Applications nos. 34044/96, 35532/97 and 44801/98, Judgement of 22 March 2001.

²⁷ Arrest Warrant of 11 April 2000 (Democratic Republic of the Congo v. Belgium), Vendim i 14 prillit 2002.

Imuniteti juridiksional mund të pengojë procedimin penal për disa kohë e për disa akuzë jo të rënda, por ky imunitet i akorduar nga e drejta ndërkombëtare nuk mund të pengojë procedimin penal në rastet kur:

- a) personat zyrtarë gjykohen nga vetë sistemi i drejtësisë së shteteve që ata përfaqësojnë;
- b) kur shteti që ata përfaqësojnë u revokon imunitetin;
- c) kur personat zyrtarë nuk gëzojnë më imunitet në bazë të rregullave të njohura nga e drejta ndërkombëtare;
- ç) kur këta persona janë subjekt i procedimit penal nga ana e Gjykatave Penale Ndërkombëtare²⁸.

Nga kjo pikëpamje, praktika e së drejtës ndërkombëtare sugjeron se nuk ka imunitete të karakterit absolut²⁹. Për më tepër, nuk mund të flitet për imunitet juridiksional kur personat zyrtarë dyshohen të kenë shkelur norma të karakterit *jus cogens*. Kjo praktikë është akomoduar edhe nga Gjykata Kushtetuese kur shprehet se:

“Përderisa në bazë të Kushtetutës rregullat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë e së drejtës së brendshme, atëherë dhe mungesa e imunitetit në proceset penale ndërkombëtare për krime të caktuara me rrezikshmëri të lartë bëhet pjesë e sistemit juridik shqiptar”³⁰.

Gjithashtu, Kushtetuta³¹ e Republikës së Shqipërisë reflekton regjim imunitetesh të kufizuara, duke i shërbyer gjithnjë mbrojtjes karshi sistemit kombëtar të drejtësisë. Një opinion i tillë konfirmohet edhe nga leximi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese:

²⁸ Arrest Warrant of 11 April 2000 (Democratic Republic of Congo v. Belgium), Vendim i 14 prillit 2002, i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, para., 59-61.

²⁹ Duhet nënvizuar fakti se vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë janë të detyrueshme jo vetëm për palët në konflikt, por edhe për shtetet e tjera që kanë njohur juridiksionin e saj.

³⁰ Vendimi V – 186/2002.

³¹ Shih, Nenet 73, 90, 103, 126, 137 të Kushtetutës.

“Statuti nuk vjen në kundërshtim as anashkalon dispozitat kushtetuese lidhur me imunitetin e kryetarit të shtetit e të një sërë subjektesh të tjera për faktin se imuniteti i këtyre subjekteve i përket juridiksionit kombëtar. Kjo nuk mund të ndalojë një organizëm ndërkombëtar si GJPN-ja në ushtrimin e juridiksionit të saj mbi persona të kësaj kategorie, të cilët kanë kryer krimet e parashikuara nga Statuti i Romës”³².

Interpretimi i ofruar na çon drejt sistemit të dy lloj përgjegjësive penale: atë përkundër sistemit gjyqësor vendas dhe atij ndërkombëtar. E thënë ndryshe, nëse subjekti përjashtohet nga përgjegjësia penale në rrafshin kombëtar, nuk përjashtohet si i tillë në atë ndërkombëtar³³.

6.2. Çështja e parimit të gjësë së gjykuar

Në kuadrin e parimit kushtetues *ne bis in idem*³⁴ vetë Statuti i Romës garanton respektimin e këtij parimi në nenet 17, 18, 19 dhe 20 të tij dhe vetë GJPN-ja nuk mund të rigjykojë raste të vendosura nga gjykatat kombëtare, përveçse kur këto raste paraqesin mangësi në këndvështrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës penale.

Po kështu, duke lexuar nenin 34³⁵ të Kushtetutës së Shqipërisë, i cili njeh parimin *ne bis in idem*, mund të thuhet se Kushtetuta jonë njeh rigjykimin e një çështjeje nga një gjykatë më e lartë mbi bazën e një ankimi ose, sipas legjislacionit të brendshëm, mbi bazën e zbulimit të një rrethane të re. Lidhur

³² Vendimi V – 186/2002.

³³ Shih për këtë mendim, raportin “Çështje Kushtetuese që rrjedhin nga ratifikimi i Statutit të Romës për GJPN-në” të përgatitur nga Komisioni Europian për Demokracinë përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), 4 (2000).

³⁴ Ky parim reflektohet edhe në një sërë dokumentesh ndërkombëtarë, si për shembull në nenin 14 pika 7 të Paktit Ndërkombëtar lidhur me të Drejtat Civile dhe Politike, dokument i cili është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

³⁵ Neni 34 i Kushtetutës thotë: “Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykim i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj”.

me marrëdhëniet e GJPN-së me strukturën gjyqësore vendase, Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se “Shqyrtimi i çështjeve nga GJPN-ja, sipas nenit 20, pika 3, shkronjat “e”, “a” dhe “b”, në vetvete ka natyrën e një rishqyrtimi, të cilin sipas dispozitës së sipërcituar të Kushtetutës e ka në kompetencë gjykata më e lartë. Me këtë shprehje, Kushtetuta nuk ka parasysh institucionin e Gjykatës së Lartë, por gjykatën më të lartë sipas një renditje të caktuar. Kështu, GJPN-ja paraqitet në fakt si gjykata më e lartë (lidhur me gjykimin e krimeve të caktuara)”³⁶.

Sipas nenit 123 (1) të Kushtetutës, Republika e Shqipërisë, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, u delegon organizmave ndërkombëtarë kompetenca shtetërore për çështje të caktuara, ndërsa në Nenin 122 (3) parashikohet se normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare në rast konflikti kanë epërsi mbi të drejtën e brendshme, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në këtë organizatë parashikohet në mënyrë eksplicite zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej saj.

Duke u mbështetur në nenin 12 (1) të Statutit, sipas të cilit shtetet palë në këtë traktat ndërkombëtar pranojnë juridiksionin e kësaj gjykate, dhe në Nenin 17 të Statutit, sipas të cilit gjykata ka të drejtë që në çdo fazë të hetimit ose gjykimin të kërkojë që çështja t’i kalojë asaj për hetim ose gjykim, mund të thuhet se GJPN-ja jo vetëm nuk ndërhyr në strukturën e brendshme gjyqësore të parashikuar në nenin 135³⁷

³⁶ Vendimi V - 186/2002

³⁷ Neni 135 i Kushtetutës thotë:

“1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.

2. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.”

7. PËRFUNDIME

Krijimi i GJPN-së dhe të gjitha zhvillimet e tjera pararendëse janë dëshmi e gjallë e përpjekjeve të vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për të lëvizur nga kultura e pandëshkueshmërisë, drejt kulturës së përgjegjësisë. Statuti i Romës reflekton bashkëpunimin ndërmjet shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile, duke premtuar standarde të larta drejtësie, të huazuara nga sistemet e ndryshme ligjore. GJPN-ja nuk ka për qëllim të zëvendësojë gjykatat kombëtare. Përkundrazi, objekti dhe qëllimi i saj është dhënia fund e epokës së pandëshkueshmërisë, në përputhje me parimin e komplementaritetit, i cili e vendos përgjegjësinë kryesore për hetimin dhe ndjekjen e krimeve të shtetet, por i siguron njëkohësisht GJPN-së ushtrimin e juridiksionit në rast se shtetet dështojnë ose e kanë të pamundur ushtrimin e përgjegjësive të dhëna.

Në këtë këndvështrim, ratifikimi i Statutit nga Republika e Shqipërisë ka përmbushur pikësëpari vullnetin institucional të shprehur që më 18 korrik në Romë. Së dyti, anëtarësimi i hershëm në OKB nënkupton juridikisht respektimin e qëllimeve dhe të parimeve të kësaj organizate, të cilat përputhen plotësisht me ato të GJPN-së. Së treti, ratifikimi dëshmon vullnetin e Shqipërisë për të luftuar genocidin, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe terrorizmin ndërkombëtar. Së katërti, nëpërmjet këtij qëndrimi garantohet më së miri respektimi i parimeve të gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare, të shprehura qartë në hyrjen dhe tekstin e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Së pesti, ratifikimi i këtij traktati ndërkombëtar pasuron frymën, drejtimin dhe traditën kushtetuese të vendit, përmes hapjes dhe ballafaqimit të legjislacionit dhe praktikave gjyqësore përkundrejt atyre ndërkombëtare.

Në një botë ideale, shkeljet e së drejtës humanitare duhet të na shpjen automatikisht të përgjegjësia penale, duke bërë që e drejta ndërkombëtare t'i konsiderojë të gjithë individët njëlloj përgjegjës për shkeljet e rënda që ata

kryejnë³⁸. Por, mungesa e një sistemi ndërkombëtar të centralizuar ka qenë pengesë e realizimit të kësaj ideje në praktikë³⁹.

Sigurisht, rrënjët e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe krimit duhen kërkuar edhe te struktura e një shoqërie të caktuar, te padrejtësitë sociale, varfëria dhe deprivimi nga pjesëmarrja në jetën publike. Nga kjo pikëpamje, evoluimi i së drejtës ndërkombëtare, i pasqyruar në krijimin e GJPN-së me fushëveprim global, nuk do të thotë zëvendësim i politikave sociale të domosdoshme për shërimin e këtyre plagëve. Kjo, edhe për faktin e thjeshtë se konturimi i GJPN-së nuk pritet të jetë proces i lehtë, ndonëse është një hap vendimtar në epokën e re që kemi nisur të ndërtojmë, atë të përgjegjësisë individuale.

³⁸ Shih për këtë argument M. Ahtisaari, Justice and Accountability: local or international?, Konferencë ndërkombëtare e zhvilluar në Utrecht, Holandë, nga data 26-28 nëntor 2001, me temë "From a Culture of Impunity to a Culture of Accountability".

³⁹ Periudha e pas 11 shtatorit 2001, ka përqendur përpjekjet ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit, duke ekspozuar, gjithashtu, edhe problemet që lidhen me mungesën e këtij sistemi të centralizuar, e në të njëjtën kohë duke rindezur polemikat rreth rolit të drejtësisë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare.

Acquis communautaire: Një koncept themelor i Integritimit European

Odeta Kumbaro
Qendra Europiane

HYRJE

Nocioni i *acquis communautaire* e ka filluesën te negociatat e para për zgjerimin e Komunitetit Ekonomik European. Shprehja u përdor për herë të parë në opinionin e Komisionit European më 1.10.1969, lidhur me kërkesën për aderim, të paraqitur nga Mbretëria e Bashkuar, Danimarka, Irlanda dhe Norvegjia. Megjithatë, Traktati i Romës përmbante një referencë të tërthortë: hyrja e traktatit shprehej se shtetet angazhoheshin për të vendosur “një bashkim më të ngushtë” midis tyre. Marrëveshja e Portos e 2 majit 1992, që krijon Zonën Ekonomike Europiane, nuk e citon *acquis*-në, por, marrëdhëniet midis Komunitetit dhe shteteve anëtare, nga njëra anë, dhe shtetet e Shoqatës Europiane të Tregtisë së Lirë (EFTA), nga ana tjetër, duhet të udhëhiqen nga një pjesë thelbësore e *acquis*-së.

Termi u njoh shprehimisht dhe u përfshi në të drejtën parësore europiane nga Traktati i Mastrihtit. Neni 2 i Traktatit të Bashkimit European (TBE) parashikon se “Bashkimi i vë vetes si objektiv të ruajë tërësisht *acquis communautaire* dhe ta zhvillojë atë” dhe neni 3 (1) i TBE-së saktëson se veprimi i Bashkimit duhet të bëhet duke respektuar dhe zhvilluar *acquis communautaire*. Neni 43 (1) (e) i TBE-së i referohet përsëri *acquis*-së si një kufi brenda të cilit mund të gjejnë zbatim

bashkëpunimet e përforcuara¹. Termi shfaqet sërish në paragrafin 2 të Protokollit, lidhur me zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit, bashkëngjitur Traktatit të Amsterdimit, i cili u imponon institucioneve komunitare “ruajtjen në tërësi të *acquis communautaire*”.

Traktati i Nisës² sjell një element të ri me futjen e termit “*acquis-ja* i Bashkimit” në nenin 44 të tij, por nuk e fshin nga tekstet ekzistuese nocionin e *acquis communautaire*, të cilit i referohet në nenin 43 të tij.

Asnjëri nga këto tekste nuk e përcakton nocionin *acquis communautaire*. Për më tepër ky term nuk përkthehet në gjuhët e tjera zyrtare të BE-së, por përdoret gjithmonë në frëngjisht. A nënkupton ky fakt se shtetet nuk arrijnë të bien dakort për përcaktimin e termit? A është kjo detyrë tepër e vështirë? Apo kemi të bëjmë me një koncept të ri juridik, i cili nuk gjen homologun e tij në asnjë nga sistemet juridike të vendeve anëtare ose në një sistem juridik ekzistues të brendshëm ose ndërkombëtar të njohur deri tani? Mund të bëjmë pyetjen nëse *acquis-ja* i cituar nga nenet 2, 3, 43 (1) (e) dhe paragrafi 2 i Protokollit për zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit ka të njëjtin kuptim. Çfarë mund të mendojmë për futjen e konceptit të “*acquis-së* të Bashkimit” nga Traktati i Nisës?

Negociatat për zgjerimin e ardhshëm, të zhvilluara në Nisë në dhjetor 2000, parashtruan nevojën e përcaktimit të kontureve të *acquis-së*, të cilin duhet ta zbatojnë të gjitha shtetet kandidatë. Rëndësia e pranimit të *acquis-së* në tërësi nga shtetet anëtare është thelbësore për vazhdimin e ndërtimit evropian; nocioni *acquis communautaire* i konceptuar si një parim themelor i këtij ndërtimi duhet t’i lejojë Europës së zgjeruar të vazhdojë procesin e integritimit të shteteve anëtare. Ardhja e shteteve të reja duhet të marrë

¹ Bashkëpunimi i përforcuar është një instrument i cili u lejon disa shteteve anëtare të Bashkimit Evropian të ecin më përpara në integrimin evropian, pa çënuar realizimet e arritura dhe duke i dhënë mundësinë shteteve të tjera anëtare të bashkohen me ta.

² Traktati i Nisës ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 2003.

parasysh krijimin e regjimeve të ndryshme që nga Traktati i Mاستrihtit: disa autorë flasin³ edhe për një shumëllojshmëri të *acquis*-ve ose për zhvillim të *acquis*-ve të ndryshme.

Acquis communautaire shfaqet si një koncept themelues i ndërtimit evropian (I). Ky koncept themelues është i pandashëm, por edhe përcaktues i së ardhmes së Europës (II).

I. ACQUIS COMMUNAUTAIRE: KONCEPT THEMELUES I NDËRTIMIT EUROPIAN

Acquis communautaire shfaqet njëherësh si një element mbrojtës (A) dhe themelues (B) i ndërtimit Evropian.

A. NJË KONCEPT MBROJTËS I NDËRTIMIT EUROPIAN

Paktheshmëria e procesit u konsakrua fillimisht nga jurisprudenca (1) dhe më pas nga traktatet (2).

1. Konsakrimi jurisprudencial i paktheshmërisë së procesit të ndërtimit evropian

Gjyqtari komunitar është i pari që do të konsakrojë paktheshmërinë ose “efektin e valvolës”⁴ së procesit të ndërtimit evropian. Në vendimin *Costa k. Enel* i 15 korrikut 1964, Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Evropiane vlerëson se “transferimi i të drejtave dhe detyrimeve, nga shtetet anëtare, nga sistemi i brendshëm juridik në sistemin juridik komunitar, ka si pasojë kufizimin përfundimtar të të drejtave të tyre sovraane, kundrejt të cilit nuk mund të ketë përparësi një akt i njëanshëm i mëvonshëm, i papajtueshëm me nocionin e komunitetit”. Ky nocion dënon çdo praktikë të njëanshme ose kolektive nga ana e shteteve që çënojnë ndërtimin evropian. Këtë e ka pohuar

³ “The *acquis communautaire*/ Has the concept had its day?” nga C. Delcourt, *Common market law review* 38, 2001.

⁴ *Le système constitutionnel communautaire*, PUF, 1999, D.SIMON.

Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane edhe në opinionin 1/75, të 11 nëntorit 1975⁵, (për rregullimin e një norme për shpenzimet vendore), ku ajo përjashtoi çdo kompetencë paralele të shteteve anëtare, lidhur me një marrëveshje e cila i përkiste politikës tregtare të përbashkët komunitare. Sipas së njëjtës logjikë, Gjykata në vendimin e 14 dhjetorit 1971, *Komisioni kundër Republikës franceze*⁶, që kishte të bënte me zbatimin e kreut të VI-të të Traktatit EURATOM, vendosi që kompetencat që i transferohen Komunitetit nuk mund të anulohen edhe kur ky nuk i ka përdorur ende ato, me përjashtim kur një klauzolë e traktatit parashikon shprehimisht të kundërtën. Gjykata e konfirmon këtë jurisprudencë në vendimin *Komisioni kundër Mbretërisë së Bashkuar* të 5 majit 1981⁷.

Gjykata vlerëson se transferimi i kompetencave është përfundimtar dhe i pakthyeshëm. Por duhet nënvizuar se këto çështje kishin të bënin me kompetencat ekskluzive të caktuara të Komunitetit dhe mund të pohojmë, se përsa i përket kompetencave konkurruese⁸, kjo jurisprudencë nuk zbatohet pasi shtetet e ruajnë kompetencën normative të tyre për atë kohë sa autoritetet komunitare ende nuk kanë ndërhyrë në një fushë të caktuar ose janë tërhequr nga ushtrimi i saj.

2. Sanksionimi i pakthyeshmërisë së procesit nga ana e Traktateve

Fillimisht, traktatet nuk parashikonin asnjë mundësi që një shtet të humbiste cilësinë e anëtarit të Komuniteteve as me anë të tërheqjes, as me anë të përjashtimit, fakt i cili do të nxirrte në pah karakterin e dobët të lidhjes së këtyre shteteve me njëri-tjetrin dhe të integritit të tyre. Po kështu, traktatet nuk përfshinin asnjë kufizim në lirinë e veprimit të shteteve anëtare. Pra, nuk kishte asnjë tekst i cili sanksiononte pakthyeshmërinë e procesit të integritit.

⁵ Mendimi 1/75, Rec. 1359.

⁶ Çështja 7/71, Rec. 1003.

⁷ Çështja 804/79, Rec. 1045.

⁸ Droit communautaire général, 7ème édition, Guy Isaac, 1999.

Ishte Traktati i Mastrihtit ai që futi termin *acquis communautaire* në të drejtën parësore për herë të parë. Karakteri i pakthyesëm i ndërtimit evropian rezulton nga fryma e Traktatit, pasi BE-ja i ndalon vetes çdo rishikim të rezultateve të arritura në kuadrin komunitar, ashtu siç e saktësojnë nenet 2, 3 dhe 47 të TBE-së. Në nenin 2 të TBE-së lexojmë se “Bashkimi Evropian i vë vetes si objektiv ... të ruajë tërësisht *acquis communautaire*”. Protokollin mbi zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit dhe neni 43 i Traktatit të Nisës ndjekin të njëjtën frymë.

Koncepti i *acquis communautaire* nuk është vetëm një koncept mbrojtës, por dhe një koncept themelor i ndërtimit evropian.

B. NJË KONCEPT THEMELOR I NDËRTIMIT EUROPIAN

Acquis communautaire është një koncept themelor, sepse nga njëra anë ai shfaqet si i paprekshëm (1) dhe, nga ana tjetër, ai përbëhet nga elemente thelbësore (2).

1. Një *acquis* i paprekshëm

“*Acquis*-ja themelore e neneve 2 dhe 3 të TBE-së është një *acquis* i rangut të epërm, i cili përfshin elementet thelbësore, kushtet, të cilat kanë të bëjnë me vetë themelet e komunitetit, rregullat, të cilat po të shkelen do të vinin në rrezik unitetin, identitetin dhe deri ekzistencën e sipërmarrjes europiane”⁹. Ky përcaktim i referohet një bashkësie rregullash, të cilat përbëjnë bërthamën e ndërtimit evropian, pa të cilat ekzistenca e tij do të kompromentohej. Në fakt, *acquis*-ja i përmendur në nenin 2 TBE nuk përfshin të gjithë të drejtën e traktateve komunitare, qoftë dhe kur bëhet fjalë për të drejtën parësore. Traktatet përbajnë tekste, të cilave mund t’u skadojë afati. Mund të përmendim Deklaratën 51 bashkëngjitur Traktatit të Amsterdimit, lidhur me nenin 10. Pra, është e mundur të vendosim një hierarki midis dispozitave, të cilat krijojnë “kushtetutën e brendshme”¹⁰ të ndërtimit

⁹ Përcaktim i dhënë nga Pescatore, ish-gjyqtar i GjDKE-së në “Aspect judiciaire de l’*acquis communautaire*”, 1981, Revue trimestrielle de droit européen.

¹⁰ Opinioni 1/76.

europian dhe të dispozitave të tjera me karakter periferik. Pas idesë së kësaj hierarkie fshihet ideja e paprekshmërisë së disa dispozitave, të cilat përbëjnë themelet e vetë Komunitetit.

Gjykata ka pasur mundësinë të shprehet në disa çështje ku ajo ka përpunuar teorinë e paprekshmërisë. Në çështjen *Defrenne* të 8 prillit 1976, Gjykata u shpreh në favor të karakterit ekskluziv të procedurës së ndryshimit të traktateve të parashikuar në nenin 48 të TBE-së. Në opinionin 1/91 të 14 dhjetorit 1991¹¹, Gjykata bën një dallim midis ish-nenit 164 (220 i ri) dhe ish-nenit 238 (310 i ri - bazë juridike e marrëveshjeve të asociimit), ku shprehet se shtetet “nuk mund të ndryshojnë sistemin gjyqësor të bashkësive me anë të një reforme të traktateve”, duke i dhënë kështu përparësi nenit 220 të TKE-së. Së fundi, duke iu referuar neneve 2, 3 dhe 48 të TBE-së, arrijmë në përfundimin se ekzistojnë disa kufij materialë¹², të cilët kushtëzojnë ndryshimin e traktateve sipas procedurës së parashikuar në nenin 48, me detyrimin për të respektuar nenin 2 të TBE-së, i cili shpall objektivat e BE-së. Gjykata ndjek metodën teleologjike, sipas të cilës interpretimi i normave bëhet nën dritën e objektivave të përcaktuar, sipas metodës së parashikuar në nenin 31 të Konventës së Vienës të 1969-s për të drejtën e traktateve.

2. Një *acquis* i përbërë nga elementë thelbësorë¹³

Acquis-ja për të cilin bëhet fjalë në nenin 2 ka të bëjë me elemente të lidhura me ekzistencën dhe identitetin e ndërtimit europian. Këto janë elemente që përbëjnë një sërë normash teknike dhe një sistem vlerash.

¹¹ “Un système hiérarchisé” nga J. Dutheil De La Rochère, Introduction au droit de l’Union européenne, Hachette, 2ème édition 1998.

¹² Commentaire du Traité sur l’Union Européenne, Kovar, Constantinesco, Simon.

¹³ “The *acquis* communautaire/ Has the concept had its day?” nga C. Delcourt, Common market law review 38, 2001.

Normat teknike, të cilat rrjedhin nga e drejta parësore, janë të tipit procedural dhe institucional. Bëhet fjalë për karakteristikat e komunitetit, modeli institucional i të cilit bazohet në pesë institucione, të cilat veprojnë së bashku, si dhe me shtetet anëtare. *Acquis*-ja institucionale përfshin parimet në të cilat bazohet struktura e Komunitetit. Këto janë parimet e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës. Ai përfshin, gjithashtu, rregullat të cilat drejtojnë marrëdhëniet ndër-institucionale, si parimi i përparësisë të së drejtës komunitare mbi atë të brendshme, i efektit të drejtpërdrejtë, i bashkëpunimit të ndershëm, i subsidiaritetit etj.

Pranë këtyre rregullave qëndron dhe *acquis*-ja e të drejtave të njeriut dhe e lirive themelore. Neni 6 i TBE-së shpreh se “BE-ja respekton të drejtat themelore të njeriut”, ashtu siç parashikohen nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare”. Të drejtat themelore të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, shpallur në Nisë, mund të bëhen pjesë e *acquis*-së, në qoftë se shtetet anëtare vendosin ta integrojnë atë në trupin e traktateve ose në qoftë se GjDKE-ja vendos ta integrojë në të drejtën europiane si parim të përgjithshëm të saj.

Më pas, përsa i përket të drejtës së derivuar, kjo nuk bën pjesë plotësisht në *acquis*, sepse disa dispozita mund të ndryshohen ose dhe të zhduken, si për shembull direktivat, të cilat mund të ndryshohen ose abrogohen.

Jurisprudenca e GjDKE-së zë vendin e saj në *acquis*. Gjykata ka nxjerrë parime themelore të sistemit komunitar, si përparësia dhe efekti i drejtpërdrejtë i së drejtës komunitare, por nuk mund të pohojmë se e gjithë jurisprudenca e saj bën pjesë në *acquis*, pasi Gjykata vetë mund të japë zgjidhje të ndryshme kur mendon se pozicioni i saj duhet të evoluojë.

Acquis-ja është themeli i ndërtimit europian: ky *acquis* themelor duhet të lejojë si zhvillimin e procesit të zgjerimit të BE-së, ashtu dhe procesin e thellimit të tij, midis të cilëve koncepti i *acquis*-së përmbledh realitete të ndryshme.

II. ACQUIS COMMUNAUTAIRE: NDËRMJET ZGJERIMIT DHE THELLIMIT TË BASHKIMIT EUROPIAN

Koncepti i *acquis*-së nuk është një koncept uniform. Nga njëra anë, zgjerimi, që u imponon shteteve kandidate një *acquis* aderimi, nxjerr në pah ekzistencën e një koncepti të gjerë në kuadrin e zgjerimit (A), ndërsa nga ana tjetër, thellimi i ndërtimit european që mbron dhe zgjeron *acquis*-në përballat me një koncept të ndryshueshëm të *acquis*-së (B).

A. Një koncept i gjerë në kuadrin e zgjerimit

Që nga hyrja në fuqi e Traktatit të Bashkimit European dhe rëndësia e madhe që i jepet këtij organizmi, negociatat për aderimet e reja ngrenë pyetjen nëse koncepti i *acquis*-së i ka lënë ose jo vend konceptit të *acquis*-së së Bashkimit European (1), duke nxjerrë në pah zhvillimin e përmbajtjes së “*acquis*-së së aderimit” (2).

1. Zhvillimi drejt konceptit të *acquis*-së së Bashkimit

Neni 49 i TBE-së parashikon se “çdo shtet european, që respekton parimet e shprehura në nenin 6 paragrafi 1, mund të kërkojë të bëhet anëtar i Bashkimit”. Koncepti përkatës “*acquis* i Bashkimit” duket se përcaktohet në disa tekste të institucioneve komunitare. Megjithatë, mungesa e qartësisë, lidhur me përdorimin e nocioneve të *acquis communautaire* dhe të *acquis* të BE-së vë në dukje identitetin e konceptit të *acquis*-së, përmbajtja e të cilit mund të ndryshojë. Komisioni në disa raporte¹⁴ të ndryshme, që lidhen me zhvillimin e procesit të aderimit të shteteve kandidate, përdor sa nocionin e *acquis communautaire*, po aq nocionin e *acquis*-së së Bashkimit. As Këshilli në raportin e tij të 1994 për “Strategjinë për përgatitjen e aderimit të vendeve të Europës Lindore dhe Qendrore” nuk i saktëson këto nocione. Në

¹⁴ Komisioni European, Raport i rregullt 2002 lidhur me ecurinë e Sllovakisë drejt aderimit në BE, 9.10.2002 Com (2002) 700 final.

përfundimet e Këshillit Europian të Helsinkit të 1999, *acquis*-ja përmendet katër herë pa u përcaktuar asnjëherë nëse bëhet fjalë për një *acquis communautaire* ose për një *acquis* të Bashkimit Europian

Traktati i Nisës sjell një element të ri në përcaktimin e konceptit të *acquis-së* në nenin 44, lidhur me kushtet e bashkëpunimeve të përforcuara, duke pohuar se aktet dhe vendimet e marra në kuadrin e një bashkëpunimi të përforcuar “nuk bëjnë pjesë në *acquis*-në e Bashkimit”. Nocioni i “*acquis-së* së Bashkimit” sanksionohet, pra, nga Traktati i Nisës.

Disa komentatorë të traktatit të Nisës¹⁵ ngritën pyetjen nëse përdorimi i *acquis-së* së Bashkimit do të çonte në zhdukjen e nocionit të *acquis communautaire*. Kjo analizë nuk mund të mbështetet, pasi vetë traktati i Nisës përdor nocionin e *acquis communautaire* në nenin 43-c. Pra, duket të ketë një bashkëjetesë termash. Kjo bashkëjetesë nuk duhet të përfaqësojë dy koncepte të ndryshme të *acquis-së*, sepse *acquis communautaire* është një *acquis* themelues, i cili nuk është një nocion uniform. Sipas kontekstit në të cilin përdoret, ai mbulon disa realitete dhe ndonjëherë (si në kuadrin e bashkëpunimeve të përforcuara dhe të *acquis-së* së aderimit) arrin të zhvillohet deri në *acquis*-në e Bashkimit. Koncepti i *acquis communautaire* është një nocion i vetëm me një përmbajtje që ndryshon. Koncepti i *acquis-së* së Bashkimit nuk dallohet nga koncepti i *acquis communautaire*, i konceptuar si një *acquis* themelor, ai e përfshin atë. Termi *acquis communautaire* nuk mund të fshihet pas termit *acquis* i Bashkimit, në qoftë se marrim parasysh karakterin e pandashëm të BE-së, shtylla komunitare e të cilit nga ana sasiore është më e rëndësishmja, kuadrin institucional dhe tendencën e komunitarizimit të politikave ndërqeveritare, pra, të dy shtyllave të tjera.

¹⁵ « The Acquis communautaire : Has the concept had its day ? » par Mme DELCOURT, CMLR 38 : p.829-870, 2001.

Në kuadrin e zgjerimit, termi i *acquis-së* së Bashkimit bën të mundur dallimin e *acquis communautaire* si *acquis* themelues nga *acquis-i* i aderimit, i cili e përfshin këtë të fundit. Përmbajtja e *acquis-së* së aderimit reflekton një zhvillim të ndërtimit evropian.

2. Zhvillimi i përmbajtjes së *acquis-së* së aderimit

Shtetet kandidate duhet të aderojnë në gjithçka që është kryer në kuadrin e BE-së ose që është duke u krijuar. Pohimi i parimit të *acquis-së* është i rëndësishëm në kuadrin e aderimit, sepse ai zgjidh problemin e periudhës që ndan negociimin e aderimit të shtetit kandidat nga hyrja efektive e tij në Bashkim.

Në çastin e aderimit të vendeve anëtare të Shoqatës Europiane për Tregtinë e Lirë, përmbajtja e *acquis-së* ishte e kufizuar nga pikëpamja sasiore: ajo i korrespondonte traktateve origjinale dhe të drejtës së derivuar të prodhuar në bazë të tyre. Megjithatë, që me aderimet e para, Gjykata e Drejtësisë dhe Komisioni tërhoqën vëmendjen për pamundësinë e copëzimit të *acquis-së*¹⁶. Ky konceptim i *acquis-së* së aderimit merr një rëndësi të madhe në perspektivën e zgjerimit të ardhshëm, në qoftë se do të marrim në konsideratë integrimin në rritje të shteteve anëtare. Shtetet kandidate duhet të plotësojnë kriteret e vendosura nga Këshilli Evropian i Kopenhagenit i 1993-it: stabilizimin e institucioneve me synim garantimin e demokracisë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, respektimin e minoriteteve dhe mbrojtjen e tyre, vendosjen e një ekonomie tregu të qëndrueshme, si dhe aftësinë për t'i bërë ballë presionit konkurrues dhe forcave të tregut brenda Bashkimit; së fundi, shtetet kandidate duhet të jenë të afta të marrin përsipër të gjitha detyrimet dhe sidomos t'u përgjigjen objektivave politike, ekonomike dhe monetare të BE-së. Respekti i parimeve mbi të cilat mbështetet ndërtimi

¹⁶ CJCE, HURD, 15 janvier 1986, lidhur me një akt të së drejtës së derivuar.

europian, u zyrtarizua nga Traktati i Amsterdimit në nenin 49 TBE, i cili parashikon se kandidatët duhet të respektojnë parimet e shprehura në nenin 6.1, që janë “parimet e demokracisë, të respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe shteti i së drejtës”.

Në raportin e tij të 7 tetorit 2000, Komisioni bën një vlerësim të zhvillimit të vendeve kandidate lidhur me ratifikimin e instrumenteve kryesore në fushën e të drejtave të njeriut (Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Deklarata e Kombeve të Bashkuara, Karta Sociale Europiane etj.): aderimi në BE kërkon aderimin në një *acquis* të tërë, sidomos në atë të Këshillit të Europës të zhvilluar jashtë BE-së, por pa të cilin ky i fundit nuk mund të kuptohet. Sipas të njëjtit objektiv, Komiteti K 4 në një raport të qershorit 1998 hartoi një listë konventash, ku vendet kandidate duhet të aderinin (Konventa për Luftën Kundër Terrorizmit, Konventa Europiane e Ndhmës së Ndërsjellë në Fushën e Kriminalitetit, Konventa e Gjenevës për Refugjatët ...).

Kësaj liste i shtohet dhe neni 8 i Protokollit që integron *acquis*-në e Schengenit në kuadrin e BE-së, i cili parashikon shprehimisht se shtetet kandidate për aderim duhet ta pranojnë atë integralisht.

Me qëllimin për të saktësuar sa më tepër përbajtjen e *acquis*-së, neni i ri 44-1, i ripërpunuar nga Traktati i Nisës, përfshijon shprehimisht nga *acquis*-ja i Bashkimit, vendimet dhe aktet e marra në fushën e bashkëpunimeve të përforcuara.

Aderimi në BE nuk u imponon shteteve vetëm detyrime në emër të parimit të *acquis*-së, por ai u njeh të drejta shteteve anëtare. Në kuadrin e aderimit, disa autorë shtruan pyetjen nëse shtetet e reja anëtare të BE-së do të përdorin kompromisin e Luksemburgut¹⁷, për të bllokuar miratimin e disa dispozitave “për arsye që kanë të bëjnë me politikën kombëtare të tyre”: kjo zgjidhje

¹⁷ Kompromisi i Luksemburgut u arrit në vitin 1966 pas politikës së « karriges bosh » të Francës, e cila bllokoi procesin e integritimit europian.

është e papranueshme, në qoftë se ne e konsiderojmë *acquis communautaire* si pjesë përbërëse e *acquis-së* së aderimit. Në fakt, *acquis communautaire*, që i korrespondon të gjithë sistemit të integritit, nuk mund të përmbajë në të njëjtën kohë një instrument që do të vinte në rrezik tërë sistemin.

Konceptimi maksimal i *acquis communautaire* në kuadrin e zgjerimit të BE-së është i nevojshëm për t'i lejuar shteteve anëtare të vazhdojnë thellimin e ndërtimit europian.

B. Thellimi i ndërtimit europian përballë një koncepti të ndryshueshëm të *acquis communautaire*

Që nga Traktati i Mاستrihtit dhe krijimit të formave të ndryshme të bashkëpunimeve, ndërtimi europian është futur në një proces integrimi origjinal, i cili është në funksion jo vetëm të aftësisë së shteteve për t'u angazhuar më thellë në “një Bashkim gjithnjë e më të ngushtë”, por dhe të vullnetit të disave për të mos marrë pjesë në zhvillimin e *acquis-së*, përkohësisht ose përfundimisht. Traktati i Mاستrihtit shënon fillimin e një prirjeje individualizimi të *acquis-së* (1). Për të ruajtur dhe zhvilluar *acquis-në*, është e nevojshme të shpjegohen format e thellimit të ndërtimit europian (2).

1. Individualizimi i *acquis-së* brenda BE-së

Që nga Mاستrihti, disa raste lejuan zhvillimin i disa *acquis-ve* që pasqyrojnë për çdo shtet anëtar veprimet e BE-së, në të cilat ai është angazhuar ose ku ka dashur të marrë pjesë. Mund të dallojmë disa forma të ndryshme të individualizimit të *acquis-së* brenda BE-së, si: a) regjimet deroguese, b) bashkëpunimet e përforcuara, c) por secila prej tyre i korrespondon një logjike të ndryshme.

a) Regjimet deroguese

Vetë traktatet parashikojnë vendosjen e regjimeve deroguese, të cilat marrin parasysh pamundësinë e përkohshme të një shteti anëtar për të marrë pjesë në një politikë të përbashkët. Kështu, marrja pjesë në fazën e tretë të

Bashkimit ekonomik dhe monetar¹⁸ supozon që shteti anëtar të plotësojë kriteret e caktuara.

Parashikimi dhe zbatimi i periudhave kalimtare për shtetet anëtare, gjatë të cilave ata duhet të kenë përfunduar harmonizimin e legjislacionit me normat komunitare, ndjekin të njëjtin objektiv. Përgjithësisht, periudhat kalimtare i lejojnë shtetet të arrijnë nivelin e arritur brenda BE-së. Në çastin e aderimit të Austrisë, Suedisë e Finlandës, negociatat e 21 dhjetorit 1993 i morën parasysh legjislacionet e zhvilluara të këtyre vendeve në fushën e mjedisit në krahasim me *acquis*-në. Në këtë mënyrë, legjislacionet kombëtare, që ishin më të zhvilluara sesa *acquis*-ja në fushën e mbrojtjes së mjedisit, lejuan përshpejtimin e tij.

Parimisht këto regjime kalimtare janë të kufizuara në kohë, sipas aftësisë së shtetit anëtar për të përmbushur kriteret e pjesëmarrjes në politikën e përbashkët. Megjithatë, në rastet kur traktati e lejon, këto shtete, që kanë aftësinë për të marrë pjesë në politikën e përbashkët, shprehin vullnetin e tyre për t'u angazhuar.

Më delikate dhe më e veçantë se individualizimi i *acquis-së* është shfaqja me traktatin e Mاستrihitit dhe më pas, e regjimeve deroguese për shtetet anëtare që nuk do të donin të merrnin pjesë në një politikë të përbashkët. Mund të marrim tre shembuj të *acquis-së* sipas dëshirës:

- Në emër të një marrëveshjeje në fushën e politikës sociale, të përmbajtur në Protokollin bashkëngjitur traktatit të Mاستrihitit, 11 shtete anëtare në fillim e 14 në vijim pranuan të angazhohen në një politikë të përbashkët në fushën sociale brenda Komunitetit, për të kompletuar dispozitat e traktateve. Përveç Mbretërisë së Bashkuar, vendimet e marra nga institucionet komunitare në këtë fushë bëjnë pjesë integruese në *acquis*. Gjatë negociimeve të traktatit të Amsterdimit, Mbretëria e Bashkuar pranoi që *acquis*-ja në fushën e

¹⁸ Kjo fazë i korrespondon kalimit në monedhën e vetme dhe në administrimin e politikës monetare nga organet komunitare.

politikës sociale, zhvilluar në bazë të Protokollit, të përfshihet në Traktatin mbi Komunitetin Europian. Pra, nuk ka më në këtë rast një *acquis* të ndryshëm.

- Protokollet 11 dhe 12 bashkëngjitur Traktatit të Mastroitit përmbajnë pozicionet e Mbretërisë së Bashkuar dhe të Danimarkës, lidhur me Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Këto shtete i plotësojnë kriteret, por refuzojnë të marrin pjesë në fazën e tretë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar: me fjalë të tjera, derisa Mbretëria e Bashkuar dhe Danimarka të vendosin ndryshe, *acquis communautaire*, i zbatueshëm për këto shtete në derogim, nuk përmban rregullat lidhur me monedhën e përbashkët dhe administrimin e politikës monetare nga organet komunitare.

- Qëndrimet e Mbretërisë së Bashkuar, të Irlandës dhe të Danimarkës, lidhur me *acquis*-në e Schengen-it, përshkruajnë regjime deroguese. Danimarka është nënshkruese e Marrëveshjes së Schengen-it, por me komunitarizimin e pjesshëm të kësaj Marrëveshjeje në titullin IV të TKE-së, Danimarka në Protokollin n.5, bashkëngjitur Traktatit të Amsterdimit, refuzon të marrë pjesë: marrëdhëniet e saj me shtetet e tjera anëtare, në kuadrin e kontrollit të kufijve, do të drejtohen ashtu siç ishin para integritit të dispozitave të Marrëveshjes së Schengen-it në BE¹⁹.

Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda, të cilat nuk janë pjesëmarrëse në Marrëveshjen e Schengen-it, refuzojnë pjesëmarrjen në përshtatjen e masave të marra në kuadrin e titullit IV të TKE-së. Protokollin n.4, në të cilin gjenden deklaratat e tyre, u lejon atyre t'i paraqesin Këshillit “dëshirën e tyre për të marrë pjesë²⁰ në miratimin dhe zbatimin e një mase të propozuar”.

Regjimet deroguese, që u lejojnë shteteve anëtare të mos marrin pjesë ose të marrin pjesë pjesërisht në integrimin europian, përbëjnë një rrezik për *acquis*-në, pasi nuk ka një vullnet të shtetit për të ndjekur objektivat e

¹⁹ Shih Nenin 2 të Protokollit n.5.

²⁰ pra shtetet që vendosen në derogacion rrezikojnë.

përbashkët, të cilët përbëjnë bazën e zhvillimit të një *acquis*-je: këto regjime ndryshojnë thelbësisht nga sistemi i bashkëpunimeve të përforcuara, i ripohuar dhe i ndryshuar nga Traktati i Nisës.

b. Bashkëpunimet e përforcuara: një mjet për promovimin e acquis-së

Sistemi i bashkëpunimeve të përforcuara u lejon shteteve që, duke respektuar kompetencat e Komunitetit, të ndërmarrin disa veprime të përbashkëta që ndryshe do të thotë të zhvillojnë midis tyre një *acquis* më të përparuar. Megjithatë, bashkëpunimet e përforcuara nuk përbëjnë një rrezik për *acquis*-në, pasi neni 43-g u imponon shteteve pjesëmarrëse të veprojnë në mënyrë të tillë që shtetet e tjera të mund të bashkohen me ta. Pra, ka një efekt ingranazhi nga ana e shteteve, të cilët dëshirojnë të ecin më shpejt në integrimin europian, duke i nxitur të tjerët të bashkohen me ta, në mënyrë të tillë që bashkëpunimet e përforcuara të jenë vetëm një formë e përkohshme dallimi. Bashkëpunimet e përforcuara janë një mjet për të forcuar efektin e ingranazhit të procesit të integritimit, i cili karakterizon ndërtimin europian, duke i imponuar një progres konstant²¹.

Objektivat e mbajtjes dhe të zhvillimit të *acquis-së* kalojnë, pra, nga një qartësim i formave të zhvillimit të ndërtimit europian.

c. Nevoja e shpjegimit të formave të thellimit për të ruajtur acquis-në

Para zgjerimit të ardhshëm, debati lidhur me mjetet për vazhdimin e ndërtimit europian është ai i ndjekjes së objektivave të përbashkët të 27 anëtarëve: si do të përputhen ruajtja dhe zhvillimi i *acquis-së* me zgjerimin e BE-së?

Vëzhgimet vijuese mund të bëhen:

Është e qartë se *acquis*-ja do ta ketë të vështirë të përcaktohet dhe të

²¹ V. Le système constitutionnel communautaire, PUF, 1999, M. SIMON : n°22 p. 48

shprehë përndjekjen e realizimeve të përbashkëta në një bashkim, ku shtetet mund të zgjedhin politikat në të cilat ata dëshirojnë të marrin pjesë. “Europa me zgjedhje” nuk është mënyra e zhvillimit të *acquis-së* me një shumicë shtetesh, ajo është mohimi i parimit të *acquis-së*, pasi ajo u lejon shteteve të zgjedhin intensitetin e tyre të integritimit.

Në kuadrin e zgjerimit, një problem më serioz ngrihet: a do të jetë e mundur të vazhdohet integrimi europian me shtete që nuk do të kenë aftësinë të angazhohen njëjloj?

Negociatat me Poloninë, lidhur me politikën e përbashkët bujqësore janë shembuj të mirë: ideja e nxjerrjes së kësaj politike nga shtylla komunitare dhe organizimi i një bashkëpunimi ndërqeveritar u diskutuan në këtë kuadër. Por, nuk duhet që zgjerimi të kompromentojë ndërtimin europian dhe *acquis-në*.

Në këtë kontekst, Europa me disa shpejtësi mund të merret në konsideratë në qoftë se ndërtimi europian do t’ia dalë mbanë me procesin e zgjerimit, duke ua bërë të mundur shteteve që duan të ecin më shpejt në realizimin e objektivave të përbashkët dhe shteteve jopjesëmarrëse, t’i arrijnë të tjerat.

BIBLIOGRAFIA

DOKTRINA

- Le système constitutionnel communautaire, PUF, 1999, M. SIMON
- Droit communautaire général, 7e éd., Guy Isaac, 1999.
- “Un système hiérarchisé” par Mme DUTHEIL DE LA ROCHERE, Introduction au droit de l’Union européenne, Hachette, 2ème éd. 1998.
- Commentaire du Traité sur l’UE, p. 882 et s. par M. KOVAR, M. CONSTANTINESCO, M. SIMON.
- “The Acquis communautaire: Has the concept had its day?” par Mme DELCOURT, CMLR 38: p.829-870, 2001.

- Elargissement: conséquences possibles de l'adoption de la proposition de la Commission, par Krisztian Kecsmar, Revue du Marché commun et de l'Union européenne, n° 434, janvier 2000

- Pour une clarification du débat sur l'Europe à plusieurs vitesses, par Florence Chaltel, Revue du Marché commun et de l'Union européenne, n° 384, janvier 1995.

JURISPUDENCE

- GJDKE 14 juillet 1964, Costa c. ENEL, Aff. 6/64, Rec. 1141

- GJDKE 11 novembre 1975, Arrangement Oede, Avis 1/75, Rec. 1359

- GJDKE 14 décembre 1971, Commission c. République française Aff. 7/71, Rec. 1003

- GJDKE 5 mai 1981, Commission c. Royaume-Uni, Aff. 804/79, Rec. 1045

- GJDKE 26 avril 1977, Fonds d'immobilisation de la navigation intérieure, Avis 1/76, Rec. 754

- GJDKE 8 avril 1976, Defrenne I, Aff. 43/75, Rec.455

- GJDKE, HURD, du 15 janvier 1986.

Proceset e globalizimit të së drejtës

Mireille DELMAS-MARTY

*Pedagoge në Universitetin I, Paris
Anëtare e Institutit Universitar të Francës*

Në lidhje me “globalizimin” dhe “të drejtën” mund të përdorim *shumësin*. Por, do të thoja, ai përbën njëkohësisht *një shans* dhe *një rrezik*.

Shumësi mbart në vetvete shansin për t’i shpëtuar globalizimit, i cili ka në qendër të tij strategjinë e pushtetit, madje të diktatit të më të fuqishmëve, pra, me një fjalë, për t’i shpëtuar kësaj monarkie universale për të cilën Kanti, kur ëndërronte për “paqen e përjetshme mes kombeve”, thoshte se kjo gjë mund të çojë në despotizmin më të tmerrshëm.

Mirëpo për ç’shumës bëhet fjalë?

Fillimisht për shumësin e aktorëve: edhe pse shtetet janë në qendër të mekanizmave ndërkombëtarë që përcaktojnë rregullat ose normat, nuk mund t’i kenë më ato monopol të tyre. Këtej e tutje individi mund të vërë në dyshim përgjegjësinë e shteteve para organizmave ndërkombëtarë, ose, e kundërta, mund të dyshohet ai vetë dhe të dënohet nga gjykatat penale ndërkombëtare. Vëzhguesit kanë vënë re rolin në rritje të organizatave private, rrjetet e të cilave as që duan t’ia dinë për territoret shtetërore. Në fushën ekonomike, 500 ndërmarrjet kryesore të botës zënë një shifër që përbën 47 për qind të

* Artikulli është përmbledhje e njërit prej krerëve të studimit me temë “E drejta e pushtuar nga globalizimi”.

prodhimit botëror dhe pothuaj dyfishin e prodhimit bruto të 107 vendeve me zhvillim të ulët ose të mesëm; në fushën sociale, organizatat joqeveritare janë bërë të pashmangshme në hartimin dhe zbatimin e rregullave, madje edhe në qëndresën ndaj lëvizjes për globalizim. Edhe pse bëhet fjalë për një nocion me shumë kuptime, pothuajse për një mit, shoqëria civile duhet të luajë rolin thelbësor, i cili është më tepër rol ricentrimi, përderisa lidh sferën publike me atë private, duke u ndodhur në një “udhë” që përfshin qëndrën dhe pjesën e përbashkët të këtyre dy sferave.

Në mungesë të një qeverie botërore, vështirësia qëndron te shmangia e rrezikut të përvetësimit të prodhimit normativ prej aktorëve më të fuqishëm. Nëse rrugët për një ripërvetësim demokratik të procesit të hartimit të rregullave dhe kontrollit të zbatimit të tyre janë për t’u zbuluar, është tashmë e qartë se ata do të kalojnë patjetër nëpër këtë “udhë”.

Por *shumësi* shpreh, gjithashtu, edhe pjesëmarrjen në lojë të atyre që do të çojnë në globalizimin e “së drejtës”. Në gjuhën e përditshme, “mondializimi” është i barabartë me “globalizimin ekonomik”, por anglishtja, e vetmja gjuhë e “mondializuar”, përmban vetëm këtë fjalë, “globalizim”, që siç dihet, është “mondializimi” i ekonomisë dhe tregut. Ky proces është tepër i favorizuar, jo vetëm për mënyrën e re të shpërndarjes në hapësirë, p.sh. investimet ose punësimet e personelit, por edhe për ndarjen e re financiare botërore, të pavarur nga shtetet. Sipas një formule të Jurgen Habermasit, “rezultati i parë i globalizimit” do të jetë dobësimi i shteteve. Aq më tepër kur ekziston edhe një tjetër proces, i cili kufizon mjaft fuqinë e shteteve dhe çon në një tjetër koncept të globalizimit: universalizimi etik, shpallur në Deklaratën “universale” të Drejtave të Njeriut. Bëhet fjalë për një ndarje të kuptimit, që duhet të përfshijë respektin për pluralizmin, duke rrezikuar të çojë në një përçarje normative, ku çdo kulturë do të kërkonte konceptin e vet për të drejtat e njeriut. Këtu shumësi do ishte edhe më i domosdoshëm, pasi ai në fushën juridike përbën një dinamikë bipolare, duke u shfaqur si rezultante e lëvizjes për globalizim të forcave të tregut dhe të drejtave të njeriut.

RREZIKU I NJË “KATASTROFE NORMATIVE”

Mirëpo e drejta ka shumë frikë nga shumësi. Sipas modelit tradicional ajo karakterizohet nga një hapësirë normash homogjene, të cilat janë të përqendruara rreth institucioneve të shtetit, me një rregull unik dhe hierarkik (unik sepse është hierarkik), si dhe qëndrueshmëria në kohë (përjashto rastet e reformave legjislative ose zhvillimet e jurisprudencës). Shumësi i aktorëve çon në çrregullime të forta të funksionimit të mekanizmave normative, si në rastet kur bëhet fjalë për hartimin e normave, ashtu edhe kur kemi të bëjmë me zbatimin e tyre. Prej këtej vjen rreziku i një “katastrofe normative”, katastrofë në kuptimin teorik të modeleve, duke shënuar kështu, përveç ndryshimit të hierarkisë, edhe një shkëputje të theksuar të nyjeve ndërvepruese, e cila do të çonte patjetër në krijimin e një modeli tjetër, krejtësisht të ndryshëm nga ai tradicional. Do të kufizohesha në ekspozenë time të kjo katastrofë normative, e cila më duket se është një nga sfidat më pak të dukshme, por në të njëjtën kohë më turbulluese, që sjell globalizimi i të drejtës. Në ndryshim nga sfidat e tjera, ajo e racionalitetit, që unë e quaj “katastrofë normative”, përfshin kryesisht juristët, pasi është, në radha të parë, sfidë e arsyes juridike:

- Në *hapësirë*, shumësi i proceseve të ndërkombëtarizimit të së drejtës çon në *ndërlikim të normave* në përmasa të atilla që sjellin emergjencën e një *hapësire policentrike*;

- rregulli prishet prej *lëkundjeve mes unifikimit dhe harmonizimit*, të cilat vijnë nga dy logjika të ndryshme dhe që mund të çojnë, përveç dobësisht të parimit të hierarkisë, në shfaqjen e *rregullit dialogjik*;

- së fundi, koha përshkohet prej mungesës së stabilitetit të pragut të pajtueshmërisë, ndryshimet e së cilës përcaktojnë kalimin nga një harmonizim i dobët, në një harmonizim të fortë, madje në një unifikim, dukuri që mund të analizohet si *koha evolutive*.

A ÇON PËSHTJELLIMI I RREGULLAVE DREJT NJË HAPËSIRE POLICENTRIKE?

“Pështjellimi”, kjo fjalë që do të thotë një lloj ngatërrimi para rregullave, shoqërohet nga disa përdredhje të çuditshme, të cilat jo vetëm ndryshojnë marrëdhëniet mes normave kombëtare dhe atyre ndërkombëtare, por shkaktojnë edhe konflikte që vënë përballë njëra-tjetrës grupe të supozuara si plotësuese, si p. sh. *e drejta e ekonomisë* dhe *e drejta e të drejtave të njeriut*.

NORMAT KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

E thjeshtëzuar me dashje, terminologjia e përdorur kufizohet në vënien përballë të normave të brendshme me ato “ndërkombëtare”, në kuptimin që i referohet të gjitha situatave kur këto norma janë hartuar dhe/ose zbatuar përtej kufijve kombëtarë, cilado qoftë shkalla e dukurisë (*rajonale*, për shembull, e drejta europiane ose *botërore*, pikërisht instrumentet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut ose gjykatat penale ndërkombëtare).

Nëse kufiri shtetëror ndan territoret nga pikëpamja gjeografike ose topografike, ai nuk mund të shërbejë si i tillë përse i përket rrjeteve (organizatave globale) të përshkruara dhe të krijuara nga një fluks gjithmonë në rritje aktorësh, strategjitë e të cilëve shtrihen në të gjithë globin. Kështu shfaqen dy fusha të mëdha, të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën: ajo ndërnacionale (marrëdhëniet mes shteteve) dhe ajo transnacionale (rrjetet që sfidojnë kufinj të). Por kapërcimi i marrëdhënieve mes shteteve sovrane çon në shfaqjen e disa normave që vihen drejtpërdrejt përballë shtetit ose individit, pra, norma me një karakter që do ta quanim “*supra nacional*”. Sipas vëzhgimeve duket qartë se shumica e instrumenteve juridike, të ashtuquajtura “ndërnacionale”, shtrihen njëkohësisht edhe në fushat e tjera (*inter, trans* dhe *supra nacional*) dhe të bësh një ndarje të tyre do të ishte diçka krejt artificiale. Përveç kësaj, shembulli i “kolonave”, përdorur në

traktatet mbi Bashkimin Europian, tregon qartë pamundësinë e ndarjes së normave supranacionale (drejtimi I) dhe atyre internacionale (drejtimet II dhe III), kur bëhet fjalë për një temë të caktuar. Traktati i Amsterdami, i cili lejon kontrollin e gjykatës mbi drejtimin e III, futet nga fusha internacionale në atë supranacionale.

Përsa i përket atij grupi normash që janë të organizuara në shkallë të ndryshme, marrëdhëniet mes tyre varen nga procesi i përfshirjes, i cili çon në një lidhje zinxhir të së drejtës kombëtare me atë ndërkombëtare rajonale, me prirje drejt asaj botërore me perspektivë ekonominë dhe të drejtat e njeriut.

Por procesi ka kuptim të dyfishtë: nëse kombëtarizimi bëhet nga e drejta kombëtare tek ajo ndërkombëtare, ai përkryhet, mund të themi, kur kthehet nga e drejta ndërkombëtare tek ajo kombëtare, pra “rikombëtarizohet”. Ja dy shembuj të një kthimi të drejtpërdrejtë, ndonëse me rezerva dhe kritika, kur bëhet fjalë për traktatet që lidhen me të drejtat e njeriut.

Në shkallë botërore, rasti i genocidit, përcaktuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1948 është tepër karakteristik. Kjo Konventë është zbatuar në fakt si prej gjykatave kombëtare, ashtu edhe prej atyre penale ndërkombëtare të krijuara *ad hoc* (për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën), në pritje të krijimit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, alternativë e cila ishte parashikuar në statutin e gjykatave penale ndërkombëtare (rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të vitit 1993 dhe 1994) dhe ai i Gjykatës Penale Ndërkombëtare (Konventa e Romës 1998). Në të dy rastet ekziston rreziku i një pështjellimi normativ: *kur* norma zbatohet nga mekanizmat e të drejtës kombëtare (të brendshme), e cila përdor specifikat e veta, çka është e pashmangshme, dhe, *kur*, megjithëse norma zbatohet nga një juridiksion penal ndërkombëtar, që mendohet se i referohet ekskluzivisht së drejtës ndërkombëtare, ndodh që ajo shpeshherë është e detyruar t’i drejtohet së drejtës së brendshme, për të plotësuar zbrazëtitë ose pasaktësitë. Kjo dukuri shfaqet edhe në shkallë më të ulëta, siç është Bashkimi Europian dhe siç e

tregon projekti i ashtuquajtur *Corpus juris* për mbrojtjen penale të interesave financiarë të këtij Bashkimi. Ky projekt ka si qëllim të unifikojë në një grup të veçantë, dhe vetëm për 15 vendet anëtare, rregullat e së drejtës penale dhe të procedurës penale lidhur me mashtrimet financiare në BE. Megjithatë, është e pamundur që çdo gjë të mund të parashikohet. Pikërisht, që të plotësohen mangësitë, projekti përmban një klauzolë “plotësimi” nga e drejta kombëtare (neni 35).

Kështu, e drejta e brendshme, në vend që të jetë e përfshirë plotësisht në normën ndërkombëtare, ruan njëfarë autonomie, ku ushqehet herë pas here kjo e fundit, madje edhe mund të zëvendësohet prej saj (prej këtej rrjedh efekti “rikombëtarizim”): pra, e drejta, e cila del nga globalizimi, çon jo vetëm në përfshirjen në të të së drejtës kombëtare, por edhe në një kombëtarizim të së drejtës botërore.

Përveç kësaj, roli i ligjvënësit kombëtar është forcuar mjaft me futjen e normave të brendshme në një grup normash ndërkombëtare, që nuk janë të bashkërenduara mes tyre. Kështu, në fushën e pastrimit të parave të pista, shumë shtete janë zotuar njëherësh në Konventën e Vienës (Kombet e Bashkuara, 1988), në dispozitat e Këshillit të Europës (Konventa e vitit 1990), në ato të së drejtës komunitare (direktiva e drejtimit të I më 1991 dhe Protokollit shtesë i drejtimit III më 1996), si dhe në ato të BE (aksioni i përbashkët kundër krimit të organizuar). Praktikisht, çdo sistem kombëtar është për dënimin e pastrimit të parave të pista, por sipas disa rregullave që variojnë nga një shtet te tjetri. Vetë shumëllojshmëria e dispozitave të zbatueshme (që s’ka të bëjë vetëm me konceptin e shtrirjes, por edhe me përcaktime të ndryshme të pastrimit të parave) e lë zgjedhjen në dorë të ligjvënësit kombëtar. E njëjta gjë mund të thuhet edhe përsa i përket luftës kundër korrupsionit, e cila i takon njëkohësisht të drejtës komunitare dhe Konventave të Këshillit të Europës e Organizatës për Bashkëveprim e Zhvillim Ekonomik; ose në fushën e të drejtës së autorit, që i takon si Organizatës Botërore të Tregtisë, ashtu edhe Organizatës Botërore për të

Drejtat e Autorit. Rreziku qëndron në faktin se “shtetet përfitojnë duke praktikuar *forum shopping*, duke zgjedhur, pra, sipas rastit, ato sisteme rregullash që atyre u duken më të favorshmet”.

Së fundi, vihet re që përshtjellimi i normave ndodh edhe ndërmjet grupeve të ndryshme rregullash rajonale për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, për shembull, një lloj kryqëzimi referencash mes normave që lidhin jurisprudencën e Konventave Europiane me ato Amerikane për të drejtat e njeriut. Mirëpo, praktika të tilla ndihmojnë në zgjidhjen e pjesshme të konflikteve mes atyre grupeve normative, të cilat kanë, në dukje, një objekt të ndryshëm nga ekonomia ose të drejtat e njeriut.

EKONOMIA DHE TË DREJTAT E NJERIUT

I njohur si bashkëjetesa e dy gjykatave, shembulli evropian është domethënës, veçanërisht për faktin se bashkimi politik nuk është realizuar ende, por vështirësitë qëndrojnë gjetiu, dhe pikërisht në dy konventat ndëramerikane (mbi të drejtat e njeriut dhe korrupsionin), ose mund të shfaqen edhe mes Mercosur-it dhe Konventës Ndëramerikane të të Drejtave të Njeriut ose OHADA-s dhe Kartës Afrikane të të Drejtave të Njeriut dhe Popujve dhe akoma më tej, në shkallë botërore mes normave të OBT-së dhe Pakteve të Kombeve të Bashkuara, me debatin mbi dispozitën sociale që OBT-ja i ktheu Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Shembulli i Europës provon se vetëm puqja mes dy grupeve normative nuk i bën dot ballë praktikës së përdorimit. *Së pari*, dy grupet e mëdha europiane janë të ndërtuara veç e veç: nga njëra anë është Europa e tregut, me sistem juridik posaçërisht për Komunitetin “ekonomik” European dhe, nga ana tjetër, Europa e të drejtave të njeriut, brenda Këshillit të Europës. Nuk ishte parashikuar asnjë përfshirje të njëra-tjetra, përveçse një afrim i thjeshtë normash, të cilat supozoheshin plotësuese dhe që mendohej të zbatoheshin për objekte të ndryshme. Megjithatë, historia progresivisht i përshtjelloi fijet. Terminologjia evoluoi me traktatin e Mastrihtit, i cili krijoi

Bashkimin European, siç u emërtua pa asnjë saktësim tjetër, Komuniteti “European”. Por u shfaq rreziku i konflikteve gjithmonë e më tepër në ato fusha ku çështja juridike përfshinte njëkohësisht ekonominë dhe të drejtat e njeriut. E drejta sociale tregon tashmë nevojën e mosndarjes së klauzolës sociale nga pjesa e së drejtës komunitare: “kjo skizofreni çon në ndreqjen me dorën e majtë (sociale) të dëmeve të shkaktuara nga dora e djathtë (ekonomike)”. Por ajo është ende më e qartë në fushat që varen njëkohësisht nga të dy grupet europiane: policat e huaja, bioteknologjitë, mediat ose procedura mbi masat administrative të së drejtës komunitare, ballafaquar me parimet e një procesi të drejtë të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (çështja *M. e Co.*, Gjykata e të Drejtave të Njeriut, 9 shkurt 1990) ose përcaktimi i nocionit medikament përballë nocionit ligjor të kimit ose dënimit sipas nenit 7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (çështja *Cantoni, Shteti Francë*, Gjykata Europiane, 15 nëntor 1996). Sigurisht që jurisprudenca përpiket të përshtatet dhe ia del shpesh të shmangë konfliktet që shkakton sistemi i ndërsjellë i informacionit ose këmbimi i referencave. Kështu, Gjykata e Luksemburgut duket se tashmë e ka njohur zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të Konventës, duke cituar madje qartë jurisprudencën e Strasburgut. Kur konflikti është i hapur, instancat e Strasburgut tregohen tepër të kujdesshme, duke konkluduar në mospranim për shembull të çështjes *M. dhe Co* ose në pranim, por pa vërejtur shkelje të Konventës si në rastin *Cantoni*. E vërteta është që në çështjen *Matthews, Mbretëria e Bashkuar* (Gjykata e të Drejtave të Njeriut, 18 shkurt 1999), lidhur me zbatimin e Protokollit të parë shtesë të Konventës për të Drejtat e Njeriut në zgjedhjet për Parlamentin European (neni 3 mbi zgjedhjet e lira), Gjykata e Strasburgut vërejtë shkelje, por pasi ishte treguar tepër e kujdesshme të nënvizonte se aktet në fjalë “nuk mund t’i nënshtrohen kontrollit juridiksional të Gjykatës së Luksemburgut”.

A mund të jetë periudha në vazhdim një përfshirje e njërës grupim normativ te tjetri dhe te cili?

Sigurisht që 15 shtetet anëtare të Bashkimit European, njëkohësisht edhe anëtare të Këshillit të Europës, e kanë ratifikuar Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe kanë njohur kompetencat e Gjykatës së Strasburgut, por Gjykata e Luksemburgut ka dhënë një mendim negativ, në vitin 1996, lidhur me një ratifikim të mundshëm të saj nga Komuniteti European. Çështja u është dërguar përgjegjëseve politikë, të cilët nuk kanë dashur ta marrin këtë mesazh ose e kanë kuptuar ndryshe, si një “autonomizim” të të drejtave të njeriut në Traktatin e Amsterdimit, përforcuar edhe me Projektkartën për të drejtat themelore të Bashkimit European, ku, është e vërtetë, nuk dihet se cili do jetë statuti dhe forca detyruese. Sidoqoftë, dualiteti nuk do të hiqet menjëherë, edhe pse disa parashikojnë tashmë zhdukjen e Gjykatës së të Drejtave të njeriut. Ndërsa në shkallë botërore, çdo gjë të bën të mendosh që distanca po thellohet (Kombet e Bashkuara dhe Organizata Botërore e Punës nga njëra anë e OBT-ja, nga ana tjetër).

Vështirësia qëndron tek arsyetimi “juridikisht”, domethënë logjikisht, brenda kësaj hapësire policentrike, ku e njëjta situatë mund të varet njëkohësisht nga shumë grupe normash të paorganizuara midis tyre. Dhe kjo vështirësi rritet edhe më tepër kur hapësira nuk është homogjene, pasi me marrëdhëniet normë e brendshme - normë ndërkombëtare globalizimi bashkon unifikimin dhe harmonizimin, gjë që e prish imazhin e rregullit normativ.

A do të çojnë luhatjet mes unifikimit dhe harmonizimit drejt një rendi dialogjik?

Nëse do të shqyrtonim proceset e globalizimit sipas një rendi të vendosjes në hapësirë, shumësi do të ishte me vend të përdorej. Sigurisht që proces unifikimi kërkojnë problemet thelbësore, siç janë parandalimi i krimeve ndaj njerëzimit, i torturës ose heqja e dënimit me vdekje etj., të cilat përjashtojnë çdo lloj marzhi kombëtar.

Rreth kësaj bërtame të fortë të të drejtave që nuk shkelen dhe krimeve të paparashkrueshme, ndodhet njerëzimi si subjekt i së drejtës. Mirëpo,

njerëzimi është shumë, dhe çështjet konfliktuale, pikërisht në fushat që prekin moralin ose fenë, nuk mund të jenë njëkohësisht edhe të unifikuara, edhe të varura nga një tjetër proces që është ai i afrimit progresiv, domethënë harmonizimi. Këtu hyn në lojë logjika juridike, pasi mënyra e arsyetimit mbi unifikimin ndryshon nga ajo për harmonizimin. Bashkekzistenca e sistemeve pjesërisht të ndryshme sjell njëfarë pluralizmi, por këto sisteme varen nga logjika të ndryshme dhe e vetmja pikë takimi që ekziston mes tyre, nuk mund të lejojë futjen e një “rendi” të vërtetë juridik. A duhen plotësuar ende kërkesat e këtij dualiteti?

UNIFIKIMI DHE HARMONIZIMI

Ajo që i bën të dallohen këto dy procese, është ekzistenca e marzhit kombëtar. Nëse *unifikimi* nënkupton rregulla fikse, të cilave shtetet duhet t’i përshtaten duke zbatuar normat me përpikëri, *harmonizimi* përbën një dobësim të hierarkisë, duke imponuar vetëm një përafrim me parimet e përgjithshme, ku çdo shtet ruan një kufi për zbatimin e këtyre normave, me kushtin që afërsia të jetë e mjaftueshme për t’u quajtur e pajtueshme. Përkufizimi i *pragut të pajtueshmërisë* është, pra, rrjedhimi që del nga kjo shfaqje e marzhit kombëtar të vlerësimit.

Sigurisht që nocioni *marzh* është në qendër të sistemeve të drejtësisë. Fillimisht është fjala për marzhin e *interpretimit* të gjyqtarit, si marrës i normës së shkruar; pastaj marzhi i dhënë nga vetë gjyqtari, si një lloj vetëkufizimi i fuqive të tij normative: për shembull, marzhi i vlerësimit që i lihet pushtetit ekzekutiv në kontrollin e Këshillit të Shtetit mbi “gabimin që shfaqet hapur”, ose marzhi i pavarësisë që i njihet Parlamentit në kontrollin prej Këshillit Kushtetues, vetëm për ato sanksione “që janë haptazi të papërshtatshme”. Cilido që të jetë përfituesi, marzhi në të drejtën e brendshme çon në një pluralizëm të tipit “metajuridik”.

Por veçoria e së drejtës ndërkombëtare është që bashkë me marzhin “kombëtar” të fusë në shumëllojshmërinë e sistemeve të së drejtës një

referencë ose një pluralizëm juridik, që do thotë, që në gjirin e rendit juridik të ekzistojnë rregullat e të drejtave të ndryshme, të zbatueshme për situata të njëjta”. Një pluralizëm ky, padyshim, i domosdoshëm në fazën aktuale, ku ndërkombëtarizimi nuk përjashton lidhjet me shumëllojshmëritë kombëtare, duke i dhënë edhe një shpjegim dukurisë së “rikombëtarizimit”.

Veçoritë *infra* nacionale, nacionale dhe rajonale mbeten të pranueshme, por ngandonjëherë edhe të acaruar ndaj marzhit kërcënues të globalizimit. Kështu, nocioni kombëtar i vlerësimit mund të çojë në një lojë zgjidhjesh me qëllim harmonizimin, i cili mund të variojë nga *pothuajse* unifikim (kur bëhet fjalë për çështje konsensuale, për shembull në fushën procedurale), në *pothuajse* kaos (nëse situata është tepër konfliktuale, pikërisht në fushat e moralit apo fesë), pa hequr dorë, megjithatë, nga kërkimi i një të drejte të përbashkët. E parë në këtë mënyrë, e drejta e përbashkët imponon një shkëputje kritike që karakterizohet nga koncepti i unifikimit të shkallëzimit të rendit juridik. Shkëputja nuk ka të bëjë me zhdukjen e çdo lloji të drejte të unifikuar, por me kombinimin e unifikimit, i cili kërkon përshtatshmëri me marzhin kombëtar, çka lejon një pjesëmarrje të pjesshme. Na mbetet të shikojmë nëse ky rikompozim “dialogjik”, në kuptimin e vërtetë të fjalës, pra, që u bën thirrje dy logjikave të ndryshme, mbetet “juridik”, domethënë objektiv aq sa mund t’u përgjigjet kërkesave të vlefshmërisë formale së sistemeve të së drejtës, e cila implikon parashikimin e vendimeve¹.

DUALITETI I LOGJIKAVE

Përmbri unifikimit që imponon “detyrimin për *përshtatje*”, harmonizimi sjell, bashkë me marzhin kombëtar, edhe një “detyrim të thjeshtë *pajtueshmërie*”. Nëse përshtatja ecën njëlloj me kërkesën për *identitet* (domethënë kërkesë për praktika kombëtare rreptësisht konform normave ndërkombëtare), pajtueshmëria mbështetet në kërkesën për *afrim*

¹ Këtu i referohemi konceptit shumëës (vlefshmëri empirike, formale dhe boshtore), përshtatur nga Ost Van de Kerchove, 1987.

(domethënë kërkesë për praktika të përafërta me normat ndërkombëtare). Vendimi i pajtueshmërisë imponon, pra, vendosjen e çështjes në një shkallë të caktuar dhe fiksimin e një *pragu*. Prandaj marzhi nënkupton ndryshime logjike, nga logjika klasike në atë të shkallëzimit, i cili krijon nëngrupime të padukshme ose *fuzzy sets*. Është e vështirë të rindërtosh një arsyetim, i cili mund të mbështesë harmonizimin në rastet kur marzhi është i nënkuptueshëm. Vetë jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut ofron shembuj të qartë. Sigurisht që marzhi kombëtar i vlerësimit nuk është i shkruar në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Si parim, ai është i përjashtuar kur kemi të bëjmë me të drejta të “padhunueshme”, që ashtu si edhe krimet, janë absolutisht të ndaluara.

Ka kohë që Gjykata e ka hequr marzhin për çështjet kur masat shtrënguese janë pranuar nga Konventa, me kushtin që këto masa të jenë “të nevojshme për një shoqëri demokratike” (neni 8-11 Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe nenet 1 dhe 3 Protokollit Shtesë nr.1) ose të jenë marrë “kur e ka kërkuar situata” (Neni 15 i Konventës). Në të dyja rastet vendos Gjykata për marzhin e interpretimit. Ajo mund të njohë njëfarë marzhi “kombëtar” atëherë kur nevojitet kufizimi i të drejtave themelore për kërkesa, për shembull të rendit publik. Në këtë rast ajo mendon se shtetet janë më në gjendje të përcaktojnë këto kërkesa sesa gjyqtarët ndërkombëtarë. Ky vetëkufizim nuk do të thotë heqje dorë nga gjithçka: thjesht bëhet fjalë për një kufi, për të cilin Gjykata kujton se “kryhet me kontroll europian”. Formula duket si e pranueshme për sa kohë “marzhi i vlerësimit” nuk është aspak i kontestueshëm. Por nga ana tjetër, zbatimi i saj është kritikuar: “Mënyra se si gjyqtari europian e merr parasysh atë mbetet problematike”. Rreziku është se subjektivizmi i gjyqtarit fiton mbi objektivizmin dhe vendimi humbet çdo lloj parashikimi. Kjo gjë quhet arbitraritet.

Siç e tregojnë edhe punimet për logjikën juridike, nuk është dualiteti i logjikave e logjikave që vë në diskutim vlefshmërinë formale të vendimit, por mosnjohja e kërkesave që i takojnë secilës, vërejtje kjo që vlen *a fortiori* në

shkallë botërore: saktësia e normës së shkruar është e domosdoshme në logjikën klasike, ndërsa pasaktësia duhet të kompensohet me shtimin e transparencës në motivim dhe të rreptësisë në zbatimin e kriterëve që përcaktojnë nocionin e pasaktë. Ky është, gjithashtu, kushti për t'ju përgjigjur kritikave që i bëhen ndryshueshmërisë së marzhit.

Paqëndrueshmëria e pragjeve të pajtueshmërisë: kohë e re drejt përparimit?

Paqëndrueshmëria tashmë është e pranishme në sistemet e të drejtës së brendshme, ku sa vjen e më tepër shfaqen pasiguria dhe rastësia. Ajo është rritur mjaft edhe në planin ndërkombëtar, sepse pa modifikuar të drejtën e shkruar dhe kriteret e jurisprudencës, ndryshimet e marzhit kombëtar dhe pragut të pajtueshmërisë mund ta ndikojnë në vendimin përfundimtar, duke e bërë normën evolutive. Padyshim që për të siguruar një “zhvillim” progresiv të së drejtës, pikërisht në fushën e të drejtave të njeriut, dukuria është e pranueshme juridikisht vetëm atëherë kur mundësohet disiplinimi i atyre ndryshimeve që shfaqen *të rastësishme*.

NDRYSHIMET E RASTËSISHME

Në fushën e të drejtave të njeriut, ku arsyetimi është tepër i qartë për t'u studiuar ose kritikuar, mbizotëron përshtypja sikur Gjykata Europiane udhëhiqet nga vlerësime oportuniste, “nga meraku se mos lëndon, se mos roli i saj pranohet më shumë nga druajtja politike përballë ndërhyrjeve të saj, sesa nga objektiviteti i misionit që ka”. Është e vërtetë që Gjykata qortohet herë për *frenim* të integritimit europian, herë për integrim *të detyruar* nga një marzh i ngushtë. Por këto dy eksese të kundërta nuk japin një zgjidhje të drejtë: “Nuk mund të pranohet që marzhi i vlerësimit të autoritetit kombëtar të dalë jashtë çdo parimi dhe rregulli që qeveris interpretimin e të drejtës ndërkombëtare, nocionet ose situatat me të cilat haset kjo Gjykatë”. Më saktësisht, vihet re një lloj rrëmuje e faktorëve që komandojnë ndryshimet e marzhit të vlerësimit, ndoshta edhe një konfuzion mes

marzhit të interpretimit të gjyqtarit europian dhe marzhit kombëtar të shteteve. Duket, në fakt, sikur Gjykata, kur përmend shtrirjen e marzhit të vlerësimit, i referohet njëherësh të dyve. Të thuash se “shtrirja e marzhit të vlerësimit varion sipas rrethanave, kërkesave dhe kontekstit”, e çon Gjykatën në marzhin e vet të interpretimit. Nga ana tjetër, të shtosh se “prania ose mungesa e një emëruesi të përbashkët për sistemet juridike të shteteve kontraktuese, mund të jetë një faktor i përshtatshëm” vlen përsëri për marzhin kombëtar të njohur prej shteteve. Por lidhja mes shtrirjes së marzhit dhe ekzistencës së një emëruesi të përbashkët nuk është gjithmonë përcaktuese. Njihen raste kur Gjykata, pa arsye objektive, duket se ka diskutuar, madje edhe ka hequr dorë fare. Kështu, në çështjen *B., shteti i Francës*, Gjykata, duke vënë re ndryshime të mëdha juridike mes së drejtës franceze dhe asaj angleze dhe duke parë se ende nuk ekziston një konsensus social në Europë lidhur me transeksualizmin, duket se nuk e pranoi atë marzh tepër të ngushtë, duke lejuar të konkludojë se situata franceze është e papajtueshme me respektin ndaj jetës private të individit². Shembuj të tillë tregojnë se jemi ende larg disiplinimit të ndryshimeve, të cilat janë përcaktuese për vendimin final.

DISIPLINIMI I NDRYSHIMEVE

Rreptësia në vendim do të kërkonte që gjyqtari jo vetëm të mbështetej në faktorë objektivë, por të dinte të dallonte edhe këto dy marzhe, për të cilat u fol më sipër. Nga njëra anë, *marzhin* e vet të *interpretimit*: në punën e vet si interpretues, gjyqtari duhet të marrë parasysh “rrethanat, kërkesat dhe kontekstin”, me kusht që të dijë t’i shpjegojë ato dhe të mos jetë subjektiv. Nga ana tjetër, *marzhin kombëtar* të vlerësimit, njohur nga vetë shtetet dhe që duhet të mbështetet në një bilanc krahasues, ndaj konflikteve të forta marzhi duhet të jetë i ngushtë, ndërsa pragu i lartë, atëherë kur, përkundrazi, konfliktet e forta nënkuptojnë një marzh të gjerë dhe prag të ulët.

² B. qytetar i Francës, 23 mars 1992, § 25.

Disiplinimi i këtyre ndryshimeve kërkon një punë paraprake: të dhënat juridike duhen të bëhen objekte studimore sistematike, në vend të vlerësimeve të përshpejtuara, që vijnë më tepër nga intuita sesa nga një metodë e vërtetë krahasuese; po kështu edhe të dhënat sociologjike ose shkencore do të kërkonin studime të thelluara. Ato do të ishin mjaft të nevojshme nëse do të prananim se në stadin aktual të zhvillimit të shoqërisë, nocioni i marzhit mbetet i domosdoshëm, për të shmangur kështu alternativën *unifikim* ose *sovrانيت*.

Shembujt e zgjedhur kanë prekur fushën e të drejtave të njeriut dhe Europën, pasi aty ekziston një jurisprudencë mjaft e qartë. Por konstatimi nuk mund të jetë i njëjtë në shkallë botërore, sepse konstrukti european, i ndihmuar mjaft nga trashëgimia pjesërisht e përbashkët, *jus commune*, ka arritur një stad integrimi të përparuar. Ne disponojmë, të paktën, një laborator të pluralizmit juridik, pasi Europa është i vetmi rajon i botës ku kërkimi për një të drejtë të përbashkët bëhet në mënyrë pluraliste. Duke qenë se përpjekjet për hegjemoni kanë dështuar dhe se unifikimi është një projekt i largët, duhet të mësojmë ta sistemojmë juridikisht këtë shumëllojshmëri. Ndërsa në shkallë botërore ky mësim lejon të imagjinojmë një alternativë të së drejtës botërore që çon në imponimin, për të gjithë globin, të modelit të shtetit më të fuqishëm, pavarësisht nga veçoritë kombëtare.

Së fundi, përfundimi mbetet i hapur, sepse shumëllojshmëria e proceseve të përshkruara mund të shërbejë si justifikim i zgjidhjeve arbitrare dhe kompleksiteti i tyre mund të japë ndihmesë në mospranimin nga shumë juristë të këtij globalizimi me shumë fytyra. Unë, nga ana ime, do të parapëlqëja kompleksitetin sesa thjeshtësinë e globalizimit. Prandaj preferoj të jem në anën e kalimit të një model i ri, që do të dëshiroja ta quaja “pluralizëm të rregullt”, duke dashur të them me këtë që e drejta mund t’ia dalë ta zbusë shumësin.³

Përktheu
Diana ESTREFI

³ Marrë nga “Revue politique et parlementaire”, N° 1015

Disa argumente juridiko-politike për pavarësinë e Kosovës

Prof. Dr. Arsim Bajrami

1. Pavarësia e Kosovës është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe rendin e ri ndërkombëtar

Pavarësia e Kosovës dhe e drejta e saj për vetëvendosje është në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe proceset e krijimit të rendit të ri ndërkombëtar. E drejta e vetëvendosjes paraqet shtyllën e demokracisë dhe të lirisë së individit dhe popujve. E drejta e vetëvendosjes, si e drejtë universale është përcaktuar në nenin 1 të Kartës së OKB-së, ku përcaktohet misioni i saj që të zhvillojë marrëdhënie miqësore midis kombeve, bazuar në respektimin e parimeve të të drejtave të barabarta dhe të vetëvendosjes së popujve dhe të ndërmarrë masa të tjera adekuate për ta forcuar paqen universale. Koncepti modern i vetëvendosjes është i përcaktuar në mënyrë të qëndrueshme në praktikën anticolonialiste të Kombeve të Bashkuara.

Parimi i vetëvendosjes u afirmua edhe me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për Dhënien e Pavarësisë Vendeve dhe Popujve të Kolonizuara, miratuar në vitin 1960. Në nenin 2 të kësaj Deklarate përcaktohet se të gjithë popujt kanë të drejtë për vetëvendosje; mbi këtë të drejtë ata lirisht përcaktojnë statusin e tyre politik dhe lirisht realizojnë zhvillimin e vet ekonomik, social e kulturor. Afirmimin dhe njohjen tjetër ndërkombëtare, e drejta e vetëvendosjes e ka gjetur edhe në dy konventa të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut: Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Kulturore e Sociale, të miratuara në vitin 1966.

Në nenin 1 të këtyre konventave përcaktohen këto elemente të së drejtës së vetëvendosjes:

1. Të gjithë popujt e kanë të drejtën për vetëvendosje; mbi këtë të drejtë ata lirisht përcaktojnë statusin e tyre politik dhe lirisht realizojnë zhvillimin e vetë ekonomik, social dhe kulturor.

2. Për mirëqënien e tyre popujt lirisht mund të disponojnë pasuritë dhe burimet natyrore, pa paragjykim për ndonjë obligim që del nga bashkëpunimi ekonomik ndërkombëtar, bazuar në parimin e përfitimit të ndërsjellë dhe të drejtën ndërkombëtare.

3. Shtetet nënshkruese të Konventës, përfshirë edhe ata që kanë përgjegjësi për administrimin e trojeve që nuk vetëqeverisen, do të promovojnë të drejtën për vetëvendosje dhe do të respektojnë atë të drejtë në përputhje me pikat e OKB-së.

Afirmimi i mëtejshëm i së drejtës së vetëvendosjes është bërë në Deklaratën e Parimeve të së Drejtës Ndërkombëtare Lidhur me Marrëdhëniet Miqësore midis Shteteve, të miratuar më 1970. Në këtë Deklaratë është ritheksuar obligimi i çdo shteti që të respektojë të drejtën për vetëvendosje në përputhje me dispozitat e Kartës së OKB-së. Rëndësia e kësaj Deklarate, shihet nga preambula e saj ku thuhet: “Të bindur se parimi i të drejtave të barabarta dhe i vetëvendosjes së popujve përmban një kontribut të rëndësishëm për të drejtën bashkëkohore ndërkombëtare, zbatim i efektshëm i tij ka rëndësi thelbësore në promovimin e marrëdhënieve miqësore midis shteteve, të bazuara në parimin e barazisë sovrane.”

Mbështetur në aktet e lartpërmendura, e drejta e vetëvendosjes u është njohur shumë popujve të shtypur (edhe jashtë kontesteve të çkolonizimit) si në rastin e Bangladeshit, të Biafrës, të Eritresë, të Kuebekut etj. Në historinë më të re politike shumë shtete të Europës Juglindore implementuan të drejtën e tyre për vetëvendosje. Në këtë kuadër, populli gjerman e realizoi të drejtën e tij për vetëvendosje më 1990, kur populli i Gjermanisë Lindore dhe asaj Perëndimore vendosi të ribashkohet, duke rrëzuar Murin e Berlinit. Në të

njëjtën kohë, deklarimet e tyre për pavarësi u shprehën edhe nga ish-republikat e Bashkimit Sovjetik gjatë viteve 1989 dhe 1991. Ishin të parat Republikat Baltike ato, të cilat realizuan vetëvendosjen, duke restauruar pavarësinë e tyre. Në proces të njëjtë kaloi edhe ish-Çekosllavia, nga e cila në mënyrë paqësore dolën dy shtete të pavarura: Çekia dhe Sllovakia.

Së fundi, pas shpërbërjes së ish-Federatës Jugosllave, katër njësitë federale të saj implementuan pavarësinë e tyre përmes vetëvendosjes dhe luftave për pavarësi.

Duke u nisur nga baza legale ndërkombëtare, Kosova paraqet rast tipik të vetëvendosjes. Vetëvendosja është një e drejtë legjitime e Kosovës dhe ka mbështetje në qenien socio-politike të Kosovës. Kosova është aneksuar dhunshëm nga Serbia që nga viti 1918. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët e Kosovës i janë bashkëngjitur luftës antifashiste vetëm me premtimin e çlirimit kombëtar dhe të realizimit të së drejtës për vetëvendosje. Ata artikulan vullnetin e tyre burimor përmes Rezolutës së Bujanit, e cila i garantonte Kosovës të drejtën e vetëvendosjes, përfshirë këtu edhe të drejtën e bashkimit me shtetin amë Shqipërinë. Mirëpo ky vullnet burimor u shtyp dhe më 1945 Kosova iu aneksua Serbisë brenda Jugosllavisë Federale. Pas shpërbërjes së Federatës Jugosllave, edhe Kosova sikur edhe njësitë e tjera federale deklarojë vullnetin e saj për pavarësi nëpërmjet referendumit të vitit 1991. Ky përcaktim doli nga e drejta për vetëvendosje e popullit të Kosovës në rrethanat e zhbërjes së ish-Jugosllavisë. Vullnetin dhe përcaktimin e tij të fuqishëm për pavarësi dhe vetëvendosje, populli shqiptar e konfirmoi edhe përmes luftës çlirimtare të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare dhe mijëra viktimave, të cilët ranë për idealin e pavarësisë dhe lirisë së Kosovës. Duke u nisur nga ajo që u theksua më lart, rrjedh se pavarësia e Kosovës ka bazën e saj juridiko-politike në të drejtën ndërkombëtare dhe paraqet një rast tipik të vetëvendosjes së popujve.

2. Pavarësia e Kosovës - një e drejtë legjitime e popullit të Kosovës
Kosova paraqet një rast tipik të vetëvendosjes dhe plotëson të gjitha

kushtet për vetëvendosje. Ajo plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara me të drejtën ndërkombëtare për të funksionuar si shtet i mëvetësishëm përsa i përket territorit, popullsisë dhe të poseduarit të qeverisë efektive.

a) Përsa i përket kriterit territorial, Kosova i plotëson kushtet e përcaktuar për të qenë shtet i mëvetësishëm. Kosova historikisht shquhet për një territor kompakt gjeografik, në të cilin me shekuj jeton populli shqiptar si popull autokton dhe si një nga popujt më të vjetër të Ballkanit. Territori si kusht për njohjen ndërkombëtare të Kosovës është më së paku kontestues. Kosova ka pasur historikisht një mëvetësi territoriale (Dardania, Vilajeti i Kosovës, KSA e Kosovës, Republika e Kosovës) dhe ka ruajtur vazhdimësinë e një hapësire të përcaktuar gjeografike dhe të definuar administrativo-juridike me identitet dhe subjektivitet të veçantë politiko-territorial dhe me kufijtë e garantuar dhe të mbrojtur në planin juridiko-kushtetues. Sipërfaqja në të cilën shtrihet sot territori i Kosovës është dukshëm më e gjerë se sipërfaqja e shumë shteteve të tjera që janë të njohura ndërkombëtarisht.

Njohja e pavarësisë së Kosovës nuk kundërshton frymën e Aktit Final të Helsinkit dhe nuk paraqet ndryshim të kufijve në Europë. Pas shpërbërjes së Federatës Jugosllave, kufijtë interfederalë dhe administrativë të Kosovës shndërrohen në kufij administrativë shtetërorë. Në aspektin juridik, kufijtë e Kosovës kanë qenë të garantuar me Kushtetutën Federative dhe me Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974. Neni 5 i Kushtetutës Federative shprehimisht përcaktonte se territori dhe kufijtë e Kosovës nuk mund të ndryshohen pa pëlqimin e saj. Së fundi, edhe vetë Rezoluta 1244 dhe Korniza Kushtetuese njohin kompaktësinë territoriale dhe pacënueshmërinë e kufijve të Kosovës. Aktualisht territori i Kosovës administrohet nga OKB-ja përmes pranisë së saj civile dhe ushtarake.

b) Realiteti etnik në Kosovë vërteton se territori i saj si historikisht, ashtu edhe aktualisht, ka qenë i banuar nga shqiptarë si popull, me shumicë absolute. Burimet historike dhe etnologjike tregojnë se shqiptarët janë popull autokton në Kosovë, shumë më të hershëm se serbët, të cilët përmes masave

administrative kanë kolonizuar Kosovën. Popullsia shqiptare në trojet e ish-Jugosllavisë dhe territori i saj etnik gjatë gjithë historisë ka jetuar dhe funksionuar si një bashkësi etnike me pjesën tjetër të shqiptarëve në Ballkan. Populli shqiptar i Kosovës është pjesë e trungut të përbashkët shqiptar, i cili në saje të pushtimeve historike është ndarë me kufij artificialë me shumë shtete të Ballkanit.

Aktualisht, Kosova, krahasuar me shtetet e tjera që dolën nga ish-Jugosllavia, paraqet një tërësi homogjene etnike. Banorët e Kosovës janë shqiptarë etnikë mbi 90 për qind, ndërsa 10 për qind janë pjesëtarë të minoriteteve të ndryshme. Me gjithë tendencat e spastrimit etnik dhe të kolonizimit serb, me të cilin u ballafaqua Kosova, ajo arriti të ruajë identitetin e shumicës absolute shqiptare. Kjo u vërtetua edhe në ngjarjet e fundit kur pas dështimit të politikës së spastrimit etnik, populli i Kosovës në mënyrë impulsive u kthye në trojet e tij etnike dhe konfirmon lidhmërinë e tij autoktone me Kosovën.

c) Kontrolli faktik mbi territorin, përkatësisht ekzistimi i qeverisë efektive, paraqet kushtin tjetër, të cilin Kosova tanimë pas themelimit të institucioneve të para demokratike e plotëson. Duke qenë një territor nën administrimin ndërkombëtar, Kosova tanimë ka themeluar institucionet qeverisëse, të cilat po ngarkohen me përgjegjësi të reja esenciale, të cilat do të transferohen nga autoritetet ndërkombëtare hap pas hapi. Krahas kësaj, Kosova është në proces të krijimit të mekanizimeve të sigurisë dhe të mbrojtjes, të cilat po aftësohen, që krahas zgjidhjes finale të statusit të Kosovës, të marrin përgjegjësitë e mbrojtjes së rendit kushtetues dhe të integritetit territorial të Kosovës. Nisur nga kjo, Kosova sot posedon kapacitetin e mëvetësishëm qeverisës dhe, në këtë aspekt, ajo kufizohet vetëm me autorizimet dhe kompetencat, të cilat ushtrohen nga autoritetet ndërkombëtare në bazë të Rezolutës 1244.

ç) Përcaktimin për pavarësi populli i Kosovës tanimë e ka konfirmuar, duke shfaqur mospajtimin e tij me sundimin e huaj dhe duke rezistuar deri në

shkallë të konfliktit të armatosur, për realizimin e idealit të tij. Pas genocidit të ushtruar ndaj popullit të Kosovës, Serbia ka humbur çdo të drejtë politike, juridike dhe morale për t' u pyetur për Kosovën.

Pavarësia nuk paraqet kurrfarë koncesioni ndaj popullit të Kosovës ose zgjidhje të okruar, por paraqet një zgjidhje reale dhe një njohje juridike të një realiteti faktik, të pranuar nga populli shqiptar, si populli shumice dërmuese e Kosovës.

Mirëpo pavarësia, si një proces i pakthyeshëm, paraqet një proces politik, dinamika e realizimit të të cilit varet nga faktorët vendorë dhe ndërkombëtarë. Shpejtësia e realizimit të këtij procesi varet nga fakti se sa shqiptarët, si populli shumice, do të arrijnë t' i dëshmojnë aftësitë e tyre shtetformuese, duke ndërtuar institucione efektive qeverisëse dhe duke ndërtuar një sistem demokratik, ku do të sigurohet sundimi i ligjit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe të pakicave. Periudha e administrimit ndërkombëtar do të jetë një periudhë e konfirmimit të aftësive qeverisëse të kosovarëve dhe e aftësisë së popullit shqiptar, për të mbrojtur pakicat dhe për të siguruar integrimin e tyre institucional. Njëkohësisht, kjo është një periudhë e një tranzicioni shumëdimensional në Kosovë dhe e krijimit të një realiteti të ri. Nga shpejtësia me të cilën do të realizohen këto procese, varet edhe dinamika e realizimit të pavarësisë së Kosovës. Pra, paraprakisht, pavarësia duhet të paraqesë një realitet faktik e më pastaj të marrë njohje juridike nga bashkësia ndërkombëtare.

3. Pavarësia e Kosovës - zgjidhje me interes për stabilitetin rajonal

Pavarësia e Kosovës, si vullnet politik i popullsisë shumicë në Kosovë, paraqet një domosdoshmëri të kohës. Bashkësia ndërkombëtare, por edhe shtetet e tjera në rajon duhet të kuptojnë se opsioni i pavarësisë së Kosovës nuk paraqet ndonjë zgjidhje të skajshme dhe program nacionalist. Pavarësia e Kosovës është një zgjidhje e drejtpeshuar e kohës që do të zgjidhë drejt krizën në Kosovë dhe do t' i japë fund konfliktit shekullor shqiptaro-serb dhe

konfliktësisë midis këtyre dy popujve. Në kuptimin e të drejtës së ligjshme për bashkim kombëtar, pavarësia e Kosovës paraqet një kompromis drejt zgjidhjes së plotë të çështjes shqiptare në Ballkan. Kjo zgjidhje do të reflektonte edhe një stabilitet afatgjatë në rajon. Pavarësia e Kosovës nuk dëmton interesat e asnjë shteti në rajon dhe nuk rrezikon shtetet fqinje. Ajo do të krijonte balance ndërkombëtare, të cilat do të garantonin sigurinë e ndërsjellë në rajon. Kjo zgjidhje do të stabilizonte Maqedoninë, e cila aktualisht sfidohet me konfliktet ndëretnike në mes të maqedonasve dhe shqiptarëve. Nuk janë të saktë zërat, se njohja e pavarësisë do të destabilizonte Maqedoninë dhe do të nxiste tendencat separatiste në këtë republikë. Përkundrazi, njohja e shtetit të Kosovës do të ulte tensionin ndëretnik në këtë Republikë dhe do të krijonte një frymë mirëbesimi dhe bashkëpunimi rajonal.

Përsa i përket Shqipërisë, pavarësia e Kosovës nuk do të nënkuptonte bashkimin e saj me Shqipërinë. Për momentin kjo do të paraqiste një zgjidhje reale që do të përcaktonte një pozicion real të Kosovës në rajon. Ky pozicion neutral do të ishte një bazë e mirë e integriteteve kombëtare dhe rajonale dhe do të hapte rrugën e integriteteve të gjera në nivel të Europës.

Duke njohur pavarësinë e Kosovës, bashkësia ndërkombëtare do të njohë një të drejtë legjitime të një populli autokton, i cili nuk kërkon asgjë më tepër se popujt e tjerë të Europës Lindore, të cilët, në saje të proceseve demokratike pas rrëzimit të Murit të Berlinit dhe mbarimit të luftës së ftohtë, filluan demokratizimin e tyre dhe procesin e integritetit në familjen e gjerë të popujve europianë.

Njohja e pavarësisë së Kosovës paraqet një proces logjik të procesit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe të krijimit të shteteve të reja mbi gërmadhat e kësaj krijese artificiale shtetërore. Pas njohjes së pavarësisë së njësisë të tjera federale, me njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe të Malit të Zi, në Ballkan do të paracaktohen raporte të reja, të cilat do të krijonin një klimë të mirëbesimit dhe fqinjësisë ndëretnike.

Tanimë duhet të jetë e qartë se çdo përpjekje për të strukturuar Kosovën brenda Jugosllavisë, në çfarëdo lidhje juridike, është plotësisht e

papranueshme, dhe ky opsion, poqe se fiton legjitimitet, mund të jetë gjenerator i krizës së përhershme dhe i konflikteve jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon në përgjithësi.

Përsa i përket opsionit, të ashtuquajtur projekt i pavarësisë së kushtëzuar, i cili është hartuar nga Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën dhe që udhëhiqet nga ish-Prokurori Publik i Tribunalit të Hagës, Riçard Gollston, ai mund të pranohet si zgjidhje e përkohshme për një periudhë më të gjatë kohore, kur do të krijoheshin kushtet për pavarësinë e plotë të Kosovës. Ky projekt parasheh katër kushte themelore për njohjen e pavarësisë së Kosovës: 1) Denoncimi eksplicit i çfarëdo ndryshimi të kufijve ekzistues të Kosovës. 2) Garantimi kushtetues i të drejtave të njeriut gjithë qytetarëve të Kosovës dhe ofrimi i sigurisë për pakicat, që të gëzojnë qasje dhe pjesëmarrje të barabartë në institucionet e Kosovës, përfshirë jurisprudencën, policinë, zyrat e zgjedhura, si dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera të tyre të përcaktuara me aktet ndërkombëtare. 3) Denoncimi i akteve të dhunës dhe qetësimi i konflikteve të brendshme dhe të jashtme dhe dekurajimi i çdo përpjekjeje për arritjen e qëllimeve politike me përdorimin e forcës dhe të mjeteve të dhunës. 4) Përkushtimi për bashkëpunimin rajonal, mbështetje rajonale dhe mbështetje institucioneve rajonale (Shih: *Whu conditional independence*, Independent International Commission on Kosovo, 2001, fq.26-27 & Kosovo Report, Independent International Commission on Kosovo, Oxford University Press, 2000).

4. Pavarësia e Kosovës - parakusht për demokratizimin e Serbisë

Njohja e pavarësisë së Kosovës nuk është një zgjidhje vetëm në interes të popullit shqiptar në Kosovë. Ajo do të ishte në interes edhe të vetë Serbisë, poqe se ajo synon demokratizimin e saj dhe integrimin në Europë. Parakusht për çfarëdo procesi të demokratizimit të Serbisë është lirimi i saj nga miti për Kosovën dhe nacionalizmi serb, i cili ishte gjenerator i konflikteve ndëretnike dhe genocidit, të cilin regjimi serb e ushtroi ndaj popujve të tjerë.

Duke pranuar realitetin se Kosova asnjëherë me vullnetin e popullit të vet nuk ka qenë pjesë e Serbisë, kjo duhet të kuptojë se sa më parë të lirohet nga dëshira për të mbajtur dhunshëm Kosovën nën sundimin e vet, aq më shpejt do të ketë gjasa të demokratizohet.

Pranimi i realitetit se Kosova asnjëherë nuk mund të jetë pjesë e Jugosllavisë, do të ndihmojë zgjidhjen e krizës kosovare dhe do të jetë bazë e një bashkëpunimi të ardhshëm ndërshtetëror.

Në kontekstin aktual politik, pavarësia e Kosovës do të ishte një zgjidhje faktike në rast të pavarësisë së Malit të Zi. Suksesi i referendumit për pavarësi në këtë Republikë, *ipso jure* do ta bënte të paqenë Rezolutën 1244, e cila bazohet në fiksionin e RF të Jugosllavisë. Një vendim i këtillë i Malit të Zi, sigurisht, do të shpejtonte realizimin e pavarësisë së Kosovës dhe do të implikonte shpejtimin e këtij procesi nga faktori ndërkombëtar. Me këtë rast, procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë do të përmbylej me njohjen formale të pavarësisë së Kosovës, të Malit të Zi e Serbisë dhe me pranimin e tyre ndërkombëtar.

Nga punimet e Kuvendit për periudhën Dhjetor 2002

Përgatiti: Alma Kondakçi

• *Projektligji “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”*

Gjatë muajit dhjetor 2002, objekt kryesor i punës së komisioneve të përhershme të Kuvendit dhe të seancave plenare të tij ka qenë shqyrtimi dhe miratimi i projektligjit “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003” dhe i paketës fiskale që shoqëronte projektbuxhetin.

Gjatë debatit të zhvilluar për projektbuxhetin në mbledhjet e komisioneve të përhershme, veçanërisht të Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, si dhe në seancë plenare, nga deputetët janë mbajtur dy qëndrime:

Së pari, qëndrimi i maxhorancës, i cili e cilësoi projektbuxhetin e vitit 2003 progresivisht më të mirë se buxhetet e viteve të fundit. Një përfundim i tillë është arritur duke e vlerësuar atë në disa drejtime kryesore:

- Projektbuxheti mbështet zbatimin e programit afatmesëm të zhvillimit ekonomik e social të vendit dhe është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit ekonomik e social të vendit.

- Projektbuxheti siguron qëndrueshmërinë e treguesve makroekonomikë dhe të rritjes ekonomike. Ai parashikon rritjen e prodhimit të brendshëm bruto me 6 për qind dhe rritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përmirësuar strukturën e shpenzimeve, të cilat orientohen në sektorët më përparësorë të Qeverisë.

- Projektbuxheti është real, ai pasqyron mundësitë reale të ekonomisë sonë për të realizuar mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave dhe mundësitë e financimit të shpenzimeve.

- Projektbuxheti e rrit në një stad më të lartë decentralizimin dhe pavarësinë financiare të pushtetit vendor. Kjo realizohet me paketën e re fiskale, sipas së cilës një kategori taksash do t'i kalojë për administrim pushtetit vendor, duke rritur të ardhurat e tij në krahasim me grantin e buxhetit të shtetit të destinuar për pushtetin vendor.

- Projektbuxheti mbështet përparësitë sektoriale të programit të Qeverisë, si arsimin, shëndetësinë, kulturën, energjinë etj.

- Projektbuxheti harmonizon më mirë shpërndarjen e investimeve sipas sektorëve dhe ndarjeve administrative.

Së dyti, qëndrimi i opozitës, i cili është kundër miratimit të projektbuxhetit me argumentet që vijojnë:

- Projektbuxheti nuk reflekton përparësitë e politikës shqiptare dhe përparësitë e zhvillimit ekonomik të vendit. Ai deformon ekonominë reale.

- Rritja e të ardhurave fiskale parashikohet në nivele të ulëta, ndërkohë që lista e tatimeve dhe taksave zgjatet dhe rritet arbitrariteti i administratës për t'i mbledhur ato.

- Struktura e projektbuxhetit nuk ka asnjë përmirësim, janë rritur shpenzimet e asistencës dhe janë ulur investimet.

- Struktura e shpenzimeve jep pak mundësi manovrimi dhe zërat e Buxhetit që po konsolidohen janë të pabazuar. Është rritur me ritme të larta zëri i shpenzimeve operative të mirëmbajtjes së Qeverisë dhe nuk ka një analizë të hollësishme të tyre.

- Rritja e pagave është parashikuar në nivele më të ulëta se inflacioni, gjë që shpreh një varfërim absolut të projektbuxhetit.

- Projektbuxheti nuk parashikon objektiva të qartë për privatizimin e objekteve kryesore, si INSIG, Telekom etj., si dhe nuk vë në efikasitet të ardhurat nga privatizimi. Kjo mund të çojë në mosrealizimin e privatizimit ose, nëse ai do të realizohet, të ardhurat prej tij do të përdoren në destinacione joefektive.

- Projektbuxheti nuk parashikon kryerjen e reformës pronësore dhe të kompensimit të pronave.

Pas debatit të zhvilluar në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare, projektbuxheti u miratua me shumicë votash më datë 20 dhjetor 2002.

Paralelisht me shqyrtimin e projektbuxhetit të vitit 2003, objekt i punës në komisionet e përhershme të Kuvendit ka qenë shqyrtimi i paketës fiskale, e cila u miratua në seancë plenare më datë 12 dhjetor 2002.

Konkretisht pojektligjet e paketës fiskale që u shqyrtuan janë:

- Projektligji “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”

E reja që sjell ky projektligj në krahasim me ligjin e mëparshëm të akcizave është ndryshimi i sistemit të llogaritjes së akcizave, nga sistemi “*ad valorem*” në sistemin me tarifa specifike (fikse). Sipas sistemit ekzistues (*ad valorem*), niveli i akcizës shprehet mbi vlerën e mallit, ndërsa sipas sistemit me tarifa specifike niveli i akcizës shprehet me kuotë fikse për çdo njësi fizike të mallit, si për mallrat e vendit, ashtu edhe për ato të importit.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit u tërhoq edhe mendimi i përfaqësuesve të biznesit, të cilët pranuan në parim vendosjen me ligj të rregullave për administrimin e mallrave të tatueshme me akcizë, por kundërshtuan vendosjen e akcizës me tarifë fikse.

Nga deputetët u mbajtën dy qëndrime për projektligjin:

Së pari, qëndrimi i pozitës, e cila mbështet variantin e paraqitur nga Qeveria për përdorimin e sistemit me tarifa specifike. Sipas tyre, sistemi me tarifa specifike rrit transparencën e administratës tatimore ndaj tatimpaguesve, pasi niveli i akcizës nuk i lihet në dorë nëpunësve të administratës, por caktohet në ligj për çdo njësi malli. Pra, kjo mënyrë e shprehjes së akcizës është edhe në interes të biznesit. Gjithashtu, përdorimi i tarifave specifike thjeshton procedurat e administrimit dhe të kontrollit si

për administratën, ashtu edhe për tatimpaguesit. Ky sistem lë më pak hapësira për evazion dhe abuzim dhe synon përafrimin me standardet e Bashkimit Europian.

Së dyti, qëndrimi i opozitës, e cila ishte e mendimit që sistemi me tarifa specifike është sistem i prapambetur. Ai mënjanon konkurrencën e drejtë, duke favorizuar disa mallra dhe duke mosfavorizuar disa të tjera. Ndaj duhet të vazhdojë të përdoret sistemi ekzistues (*ad valorem*), duke forcuar punën administrative për të shmangur abuzimet dhe evazionin.

Pas diskutimit të projektligjit, me shumicë votash u miratua në parim llogaritja e akcizës sipas sistemit fikse, duke shprehur me kuotë fikse edhe akcizën e karburanteve, me përjashtim të gazoilut, akciza e të cilit llogaritet në përqindje ndaj vlerës së tij. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit u miratuan një sërë amendamentesh me ndryshime, sipas propozimeve të deputetëve.

Pjesë përbërëse e paketës fiskale të shqyrtuar në këtë periudhë është edhe ndryshimi i ligjit nr. 8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Projektligji i paraqitur nga Qeveria synon ndarjen e tij në dy ligje organike, si më poshtë:

- ***Projektligji “Për sistemin e taksave kombëtare”;***
- ***Projektligji “Për sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore”.***

Pra, nga projektligji “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” hiqet kreu i taksave vendore, i cili paraqitet si ligj organik më vete.

Gjatë debatit, deputetët e mbështetën këtë ndryshim të ligjit ekzistues si një hap përpara që ndihmon në decentralizimin e pushtetit vendor, duke i dhënë më shumë kompetenca organeve vendore, për t’u zhvilluar në përputhje me burimet financiare. Me këtë ligj të ri të pushtetit vendor kalojnë në administrim të bashkive e komunave tatimi mbi biznesin e vogël, tatimi mbi tokën bujqësore dhe tatimi mbi pasurinë e paluajtshme.

Projektligji që trajton taksat kombëtare nuk parashikon rritje taksash, madje

disa prej tyre janë ulur. Në këtë projektligj futen dy taksa të reja për produktet që dëmtojnë mjedisin.

Të dyja projektligjet u miratuan në seancë plenare me një sërë ndryshimesh, për përmirësimin e përmbajtjes dhe të terminologjisë së tyre, si dhe përputhjen e tyre me Kushtetutën.

- Projektligji “Për tatimin vendor mbi biznesin e vogël”

E reja në këtë projektligj është kalimi i këtij tatimi në administrimin e organeve të pushtetit vendor, ndërkohë që deri tani ai është administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Tatimi mbi xhiron i bizneseve të vogla do të administrohet nga ligji “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit deputetët ranë dakord që ky tatim të administrohet nga organet e qeverisjes vendore. Deputetët theksuan se ky projektligj do të rrisë interesin e organeve të pushtetit vendor për evidentimin, regjistrimin dhe pagimin e detyrimeve tatimore nga të gjithë personat që detyrohen sipas këtij ligji, pasi të ardhurat nga ky tatim do t’i kalojnë buxhetit vendor të bashkive e komunave, duke shtuar burimin e të ardhurave të pushtetit vendor.

Duke qenë se projektligji parashikon që biznesi i vogël t’i nënshtrohet si tatimit mbi biznesin e vogël, ashtu edhe tatimit mbi të ardhurat, deputetët e opozitës u shprehën kundër këtij detyrimi të dytë, i cili e rëndon biznesin e vogël nga ana financiare.

Në përfundim të diskutimit, projektligji u miratua sipas propozimit të Qeverisë, duke bërë disa ndryshime në disa nene, për përmirësimin e përmbajtjes së tij.

- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshimet përkatëse.

Nevoja e ndryshimit të këtij ligji lind si rezultat i reformës për decentralizimin e pushtetit vendor dhe kalimit të tatimit të biznesit të vogël

në administrimin e tij, ndërkohë që deri tani ky administrim është bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Gjithashtu, në këtë projektligj zëvendësohet koncepti i tatimit mbi xhiron me konceptin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, me qëllim që edhe kategoria e tatimpaguesve të biznesit të vogël të vihet në kushte të barabarta me individët dhe shoqëritë tregtare që paguajnë tatim mbi të ardhurat.

Të gjitha bizneset e vogla me xhiro deri në 8 milionë lekë në vit do të paguajnë tatim të thjeshtuar mbi fitimin. Tatimi i mbledhur derdhet në buxhetin e bashkisë dhe të komunës, ku është i regjistruar tatimpaguesi.

Gjatë diskutimit, deputetët e miratuan projektligjin pa ndryshime.

- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Projektligji bën disa rregullime në disa dispozita të tij, veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me interesat dhe detyrimet e papaguara në afat. Ai parashikon uljen e interesave për detyrimet e papaguara në afat, duke i përfaqësuar ato me interesat maksimale të Bankës së Shqipërisë.

Gjithashtu, projektligji i jep kompetencë organeve tatimore të mbyllin mjediset ku ushtrohet veprimtaria e tatimpaguesve që nuk paguajnë detyrimet tatimore ndaj shtetit, për aq kohë sa ata të kenë shlyer detyrimet.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, deputetët ranë dakord me projektligjin e paraqitur nga Qeveria dhe e miratuan atë pa ndryshime.

- Projektligji “Për miratimin e nivelit të tarifës doganore”

Ky projektligj parashikon ndryshimin tërësor të nomenklaturës së mallrave në përshtatje me nomenklaturën e mallrave të OBT-së dhe ndryshimin drejt uljes të tarifës doganore për një numër relativisht të madh të artikujve të nomenklaturës së mallrave, sidomos për grupmallrat e lëndëve të para farmaceutike, lëndëve të para për industrinë ushqimore, rasatet e peshkut dhe rrjetat e peshkimit, lëndët e para për prodhimin e cigareve, si dhe uljen e

tarifës doganore për makineritë bujqësore, të ndërtimit, të minierave dhe të punimit të metalit.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, deputetët e miratuan atë në parim me shumicë votash.

Deputetët e opozitës paraqitën disa vërejtje për projektligjin, veçanërisht në drejtim të përdorimit të sistemit të referencave në caktimin e tarifave doganore.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi disa ndryshime në disa tarifa doganore. Ndryshimi më kryesor ishte rritja e tarifës doganore për birrën e prodhuar në vend me 20 për qind, për të zbutur efektin negativ që jep vendosja e akcizës me tarifë fikse për njësi prodhimi për këtë produkt. Ndryshimet e tjera kanë të bëjnë me uljen e tarifave doganore në disa mallra të tjerë.

Si rrjedhim i këtyre ndryshimeve në tarifatat doganore, nuk ka ndonjë efekt të ndjeshëm në ndryshimin e të ardhurave doganore.

Projektligjet e paketës fiskale u miratuan nga Kuvendi me shumicë votash. Opozita votoi kundër tyre.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako
Jurist

Ligj nr.8853, datë 31.1.2002 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore”. Përfaqësuesit e shteteve që ndërmorën nismën për këtë Konventë përfunduan bisedimet më 28 tetor 1979 dhe më 3 mars 1980 ajo u hap për nënshkrim për shtetet që donin të ishin anëtare. Me ligjin nr.8853, datë 31.1.2002 edhe Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore”. Konventa në përmbajtjen e saj rregullon dhe mban parasysht nevojën e lehtësimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në përdorimin paqësor të energjisë bërthamore, shmangien e rreziqeve të mëdha që shkakton marrja dhe përdorimi i paligjshëm i materialit bërthamor, miratimin e masave efektive për të siguruar parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e shkeljeve, marrjen e masave efektive për mbrojtjen fizike të materialit bërthamor, si dhe një sërë problemesh të tjera që lidhen me lëvizjen e sigurt të materialit bërthamor, mbrojtjen fizike të tij në përdorimin civil, magazinimin dhe transportimin etj. Kjo Konventë do të zbatohet për materialet bërthamore të përdorura për qëllime paqësore. Pjesë përbërëse të saj janë edhe Aneksi (shtojca) I që flet për nivelet e mbrojtjes fizike për t’u zbatuar në transportin ndërkombëtar të materialit bërthamor, siç karakterizohet në Aneksin (shtojcën) II, që flet për kategorizimin e materialit bërthamor. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më

23.2.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.2 të vitit 2002, në faqen 19. Ligjit i bashkëlidhet Konventa dhe dy Anekset (shtojcat).

Ligj nr.8854, datë 31.1.2002 “Për ratifikimin e Protokollit të bisedimeve ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar dhe teknik për vitin 2001”. Bisedimet qeveritare mbi bashkëpunimin financiar dhe teknik për vitin 2001 midis delegacionit të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe delegacionit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, janë zhvilluar në Tiranë në datat 4 dhe 5 dhjetor 2001. Protokollin vë në dukje përkrahjen e fuqishme të Republikës Federale të Gjermanisë për shumën 23.9 milionë Euro për rregullime në furnizimin me ujë dhe kanalizime, për energjetikën, reformën ekonomike, ngritjen e ekonomisë së tregut etj. Gjithashtu, nga Protokollin del se pala shqiptare ka dhënë garanci për ndjekjen e punës në mënyrë intensive, sidomos për furnizimin me ujë në Elbasan, furnizimin me ujë dhe kanalizimet në Kavajë, për reformat institucionale në KESH, për ndihmat në mallra për sektorin e bujqësisë, për investimet sociale etj. Në Protokollin jepen në mënyrë shumë të detajuar edhe shumë punime të tjera që do të kryhen, kontributin financiar për secilën prej tyre etj. Në fund të Protokollit gjendet edhe një Deklaratë e delegacioneve të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.2.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.2 të vitit 2002, faqe 28. Ligjit i bashkëlidhet Protokollin dhe Deklarata.

Ligji nr.8855, datë 31.1.2002 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për shtyrjen e pagesave të borxhit (Marrëveshja “Shqipëria III”). Sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t’i lejojë

